



This programme is funded
by the European Union



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

MANUAL

PJESËMARRJA E
ORGANIZATAVE JO FITIMPRURËSE
NË PROCESIN E MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË KONVENTËS CEDAW
DHE KONVENTËS SË STAMBOLLIT
DHE RAPORTIMIT PËRPARA
KOMITETIT CEDAW, UPR DHE
GREVIO

“Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Ngritja e një rrjeti të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri”, i zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian dhe zbatuar me mbështetjen e UN WOMEN. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e e autores dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e UN WOMEN dhe as të Komisioni Evropian.”

Përgatiti manualin: Dr. Nadia Rusi

TIRANË 2018

Përmbajtja

- I. Shkurtime 6
- II. HYRJE 7

PJESA E PARË

1. PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE NË PROCESIN E MONITORIMIT TË KONVENTËS CEDAW DHE RAPORTIMIT PËRPARA KOMITETIT CEDAW	10
1.1 Pse ishte i nevojshëm hartimi i një manuali për OJF në lidhje me monitorimin e zbatimit të Konventës CEDAW?	10
1.2 Çfarë është CEDAW?	11
1.3 Cilat janë fushat që mbulon Konventa CEDAW?	11
1.4 A ka detyrime për shtetin shqiptar në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, që burojnë nga Konventa CEDAW?	12
1.5 Cili është roli që luajnë organizatat e shoqërisë civile në aktivitetin e Komitetit CEDAW?	13
2. MONITORIMI I KONVENTËS CEDAW DHE REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT CEDAW	15
2.1 Pse është e rëndësishme për OJF-të të monitorojnë zbatimin e Konventës CEDAW dhe rekomandimet e Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore?	15
2.2 Cilat janë fazat e monitorimit dhe ku mund të njihen OJF-të me detyrimet që ka shteti shqiptar për të përmbushur në bazë të Konventës?	16
2.3 Cilat janë disa nga treguesit që mund të përdoren nga OJF-të në monitorimin e standardeve që burojnë nga CEDAW në lidhje me adresimin e dhunës ndaj grave?	17
2.4 Cilat janë disa nga burimet që mund të shfrytëzojnë OJF-të për të marrë informacion në lidhje me vlerësimin e treguesëve për adresimin e dhunës me bazë gjinore?	18
2.5 Çfarë metodash mund të përdoren nga OJF-të për monitorimin e zbatimit të Konventës nga ana e shtetit?	20
2.6 Kërkese për informacion	21

3. PROCESI I RISHIKIMIT TË KONVENTËS NGA KOMITETI CEDAW DHE PARAQITJA E RAPORTEVE HIJE/ALTERNATIVE.	22
3.1 Si është i organizuar procesi i rishikimit dhe cilat janë hapësirat e pjesëmarrjes së OJF-ve në këtë proces?	22
3.2 Pse është e rëndësishme për OJF-të që të përfshihen në procesin e rishikimit?	23
3.3 Çfarë është sesioni i para-rishikimit dhe cili është roli i përfshirjes së OJF-ve në këtë proces?	23
3.4 Çfarë duhet të kenë parasysh OJF-të, nëse mund të marrim pjesë gjatë sesioneve të rishikimit?	24
3.5 Cilat janë format e raporteve që OJF-të mund t'i dërgojnë Komitetit CEDAW?	26
3.6 Çfarë hapash duhet të ndërmarrin OJF-të për të përgatitur një raport Hije/Alternativ?	27
3.7 Cila është struktura e raportit hije të OJF-ve?	32
3.8 Cili është roli i OJF në përgatitjen e Vërejtjeve Përmblyëse dhe Rekomandimeve nga Komiteti CEDAW?	33
3.9 Çfarë është procedura Follow-up dhe cili është roli i OJF-ve në këtë procedurë?	34
3.10 Cilat janë rregullat procedurale që OJF duhet të ndjekin në hartimin e raportit follow-up?	34
3.11 Si mund të monitorojmë zbatimin e rekomandimeve follow up të Komitetit CEDAW për Shqipërinë dhe cilat janë disa nga treguesit që mund t'i shërbejnë OJF-ve për të matur zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komitetit nga shteti shqiptar gjatë fazës follow-up?	35

PJESA E DYTË

2. PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË PROCESIN UPR.	42
2.1 Hyrje	42
2.2 Çfarë është UPR?	42
2.3 Kush merr pjesë në procesin e rishikimit? A mund të marr pjesë unë si OJF në Grupin e Punës?	43
2.4 Cilat janë instrumentat objekt rishikimi?	44
2.5 Cilat janë dokumentat bazë objekt i procesit UPR?	44
2.6 Pse duhet OJF të konsultohet me qeverinë në fazën para përgatitore?	45
2.7 A mund unë si OJF të dërgoj informacion në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut direkt tek Këshilli i OKB?	46
2.8 Çfarë duhet të përmbajë raporti i dërguar nga OJF që të pranohet nga Këshilli?	46
2.9 Çfarë duhet të kem parasysh për të hartuar një raport të suksesshëm në fushën e dhunës me bazë gjinore?	47
2.10 Pse është me rëndësi për mua si organizatë të lloj me shtetet e tjera?	49
2.11 A mund të marr pjesë në sesionet e Grupit të Punës gjatë UPR?	50
2.12 A mund të ndërhyj unë si OJF në mbledhjen e Këshillit të të Drejtave të Njeriut pas procesit të rishikimit?	51
2.13 Çfarë roli kanë OJF në fazën Follow-up për të siguruar zbatimin e rekomandimeve nga shteti?	51

PJESA E TRETË

3. PJESËMARRJA E OJF NË PROCEDURËN E MONITORIMIT NGA GREVIO	54
3.1 Çfarë është GREVIO?.....	54
3.2 Çfarë është Komiteti i Palëve?	54
3.3 Si realizohet procesi i monitormit të Konventës nga GREVIO?	55
3.4 Roli i OJF-ve në procesin e monitorimit të Konventës	55
3.5 Pse është e rëndësishme për OJF të marrin pjesë në procedurën e monitorimit të GREVIO-s?.....	56
3.6 Si mund të marr pjesë unë si OJF në procesin e monitorimit të GREVIO-s?.....	57
3.7 Kur mund t'i dërgoj unë si OJF informacion GREVIO-s?	58
3.8 Si duhet ta strukturoj raportin për GREVIO-n? A duhet të raportoj mbi të gjitha nenet e Konventës?	58
3.9 A i bën publike GREVIO informacionet që unë si OJF i jap?	59
3.10 A mund të kem vështirësi unë si OJF në pjesëmarrjen aktive në procesin e monitorimit?.....	60
3.11 Çfarë mund të bëj unë si OJF për të rritur ndikimin tim tek GREVIO?	60
3.12 Cilat janë masat urgjente të identifikuar nga GREVIO për të cilat duhet të raportojë Shqipëria dhe që do të bëhën burim i monitorimit nga ana juaj si OJF?	61
3.13 Rast Studimor: Shkëputur nga Modeli austriak/ Struktura e Raportit Hije të OJF	66
SHTOJCA	
Shtojcë.1	68
Vështrim krahasues i raporteve hije të organizatave të huaja: Shembuj të mirë (Austria/Australia), Praktika për t'u përmirësuar (Egjypt/ Meksika)	68
Shtojcë. 2	71
Pyetëtori mbi masat legjislativë dhe masa të tjera sipas dispozitave të Konventës së Këshillit të Europës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje	71
APPENDIX	86
BIBLIOGRAFIA:	88
FAQE INTERNETI:	89

I. Shkurtime

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave – CEDAW

Komiteti CEDAW- Komiteti që monitoron zbatimin e Konventës CEDAW, interpreton dispozitat e saj dhe shqyrton ankesat e individëve për shkeljen e Konventës

Organizata jo fitimprurëse – OJF

Vërejtje Përmbyllëse – VP

Urdhra Mbrojtës- UM

Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtës- UMM

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare- QNL

Ministria e Drejtësisë – MD

Procesi i rishikimit Periodik – UPR

Konventa Për parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – Konventa e Stambollit

Këshilli i të Drejtave të Njeriut - KDN

II. HYRJE

Ky manual përman një informacion të detajuar të mekanizmit të monitorimit dhe raportimit të organizatave jofitimprurëse përpara Komitetit CEDAW, GREVIO dhe UPR. Në hartimin e tij kemi pasur si qëllim që, përmes informacionit të ofruar, t'i ofrojmë ndihmë dhe të lehtësojmë përfshirjen e çdo organizate jofitimprurëse në Shqipëri në procesin e monitorimit të konventave ndërkombëtare edhe rajonale në mbrojtje të të drejtave të grave dhe raportimit të tyre përpara komiteteve ndërkombëtare.

Nga pikëpamja strukturore manuali është i ndarë në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohet pjesëmarrja e OJF në procesin e monitorimit të Konventës CEDAW dhe raportimi përpara komitetit CEDAW. Pjesa e dytë i referohet procesit të monitorimit të Konventës së Stambollit nga OJF dhe raportimi i tyre përpara GREVIO-s dhe pjesa e tretë dhe e fundit ndihmon OJF me informacion të detajuar në lidhje me procesin e Rishikimit Periodik Universal dhe rolin e tyre në këtë proces.

Në raportimet e mëparshme të Shqipërisë, OJF-të kanë treguar se mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kuadër të zbatimit efektiv të Konventës CEDAW, Konventës së Stambollit apo instrumentave të tjera ligjore ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Përmes monitorimit dhe raportimit në lidhje me progresin e bërë nga Shteti Shqiptar në përmbushjen e detyrimeve të këtyre Konventave ndërkombëtare, OJF-të kanë ndihmuar në evidentimin e problemeve specifike të zbatimit të Konventave dhe të aktorëve përgjegjës për zgjidhjen e tyre, duke dalë me propozime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të grave në Shqipëri. Gjithashtu, raportet e paraqitura nga OJF-të e kanë ndihmuar Komitetin CEDAW dhe grupin e ekspertëve të GREVIO-s për t'u njohur me situatën reale të grave në Shqipëri dhe nevojat që ato kanë, me qëllim formulimin e rekomandimeve që i përgjigjen këtyre nevojave.

Për sa më sipër, ky manual i drejtohet të gjitha OJF-ve që do të përfshihen në procesin e monitorimit të këtyre Konventave dhe të raportimit përpara Komiteteve respektive. Orientimi i OJF-ve me treguesit dhe metodat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komiteteve në fushën e dhunës me bazë gjinore, ka si qëllim rritjen e ndikimit të tyre në mekanizmat ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave, viktimat të dhunës gjinore. Gjithashtu, njohja me rregullat procedurale të nevojshme për hartimin e raporteve hije/alternative si dhe ofrimi i praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare për këtë qëllim do t'i ndihmojë OJF-të në përgatitjen e

raporteve sa më efektive për Komitetin CEDAW, GREVIO dhe Këshillin e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, ky manual ka si qëllim të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit të OJF-ve në fushën e dhunës me bazë gjinore si dhe të inkurajojë forcimin e dialogut efektiv midis OJF-ve në Shqipëri dhe mekanizmave institucionale përgjegjës për zbatimin e Konventës CEDAW dhe Konventës ë Stambollit dhe shoqërisë civile. Dialogu do të orientohet nga detyrimet që ka marrë përsipër shteti shqiptar me ratifikimin e të dyja Konventave , me qëllim eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, përfshirë edhe dhunën me bazë gjinore.

PJESA E PARË

1. PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE NË PROCESIN E MONITORIMIT TË KONVENTËS CEDAW DHE RAPORTIMIT PËRPARA KOMITETIT CEDAW

1.1 Pse ishte i nevojshëm hartimi i një manuali për OJF në lidhje me monitorimin e zbatimit të Konventës CEDAW?

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që ka si qëllim të eliminojë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe të promovojë të drejta të barabarta midis burrave dhe grave në të gjithë botën. Deri më sot 189 Shtete janë palë të Konventës. Shqipëria është pjesë e kësaj Konventë që nga viti 1994. Rëndësia e CEDAW në mbrojtjen e të drejtave të grave lidhet me detyrimin që kanë Shtetet palë në këtë Konventë për të promovuar, mbrojtur, respektuar dhe përmbushur një gamë të gjerë të drejtash në kuadër të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit të grave si dhe me qëllim për të siguruar sisteme mbrojtëse adekuate për të përmirësuar pozitën e grave në të gjitha fushat e jetës. Dhuna me bazë gjinore është parashikuar nga Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 i Komitetit si një nga pengesat kryesore të arritjes së barazisë reale midis burrave dhe grave si dhe të realizimit efektiv të të drejtave të grave në të gjitha fushat e jetës.

Plotësimi i detyrimeve konventore të Shteteve monitorohet nga Komiteti CEDAW, një grup prej 23 ekspertësh të pavarur të të drejtave të njeriut. Një nga mënyrat e monitorimit të zbatimit të Konventës nga Shtetet është përmes procesit të rishikimit periodik, përmes të cilit Shtetet Palë janë të detyruar të raportojnë tek Komiteti CEDAW çdo 4 vjet, në lidhje me masat që ata kanë marrë për të zbatuar Konventën. Raportimi periodik i Shteteve është një mekanizëm me rëndësi në evidentimin së pari të progresit që ata kanë bërë në lidhje me zbatimin e Konventës dhe së dyti të fushave më problematike që kanë nevojë për ndërhyrje.

Pjesa e parë e manualit është hartuar për t'u ardhur në ndihmë organizatave jofitimprurëse me qëllim një përfshirje sa më të madhe të OJF-ve në Shqipëri në procesin e monitorimit të zbatimit të Konventës dhe raportimit përpara Komitetit si edhe për t'iu ofruar atyre një mjet për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në këtë proces. Edhe pse një pjesë e OJF-ve në Shqipëri kanë marrë pjesë në këto procese në sesionet e mëparshme të rishikimit të Komitetit CEDAW, sërish është evidentuar nevoja e forcimit të njohjes së organizatave jofitimprurëse me procesin e rishikimit të zbatimit të konventës CEDAW si dhe

me mundësitë që ato kanë në dispozicion për t'u bërë pjesë aktive e këtij procesi.

Me qëllim që të kishim një tablo më të qartë të kërkesave të organizatave në këtë fushë, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) hartoi një pyetësor drejtuar organizatave jofitimprurëse në Shqipëri në lidhje me procesin e monitorimit të zbatimit të Konventës si dhe përgatitjes së raporteve hije/alternative për Komitetin. Ajo që u evidentua ishte fakti se pjesa më e madhe e organizatave të pyetura nuk kishin njohuri të thelluara në lidhje me procesin e monitorimit të Konventës dhe raportimit përpara Komitetit CEDAW. 66% e organizatave nuk kishin marrë pjesë në asnjë trajnim për rritjen e kapaciteteve të tyre për monitorimin e zbatimit të Rekomandimeve të Komitetit dhe 76% e tyre nuk kishin marrë pjesë në aktivitete në lidhje me rritjen e kapaciteteve të stafit të tyre për hartimin e raporteve hije/alternative. 95% e OJF nuk kishin përgatitur asnjëherë raport hije/alternative për Komitetin CEDAW. Për më tepër edhe ato pak organizata që ishin përfshirë ndërkohë në procesin e raportimit përpara Komitetit nuk kishin konsultuar ndonjë udhëzues në lidhje me shkrimin e tyre.

Megjithatë, ajo që vlen të nënvizohet është interesi i lartë i OJF-ve për t'u përfshirë në mënyrë aktive në sesionet e ardhshme të rishikimit nga Komiteti. 73 % e organizatave të pyetura kanë shprehur interesin e tyre për t'u përfshirë në të ardhmen në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit CEDAW dhe 62% e tyre treguan gatishmërinë e tyre për t'iu drejtuar Komitetit CEDAW me një raport hije/alternative në sesionin e ardhshëm të rishikimit për shtetin Shqiptar.

Për sa më sipër, kjo pjesë e manualit është hartuar me qëllim për t'i shërbyer OJF-ve në Shqipëri, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të tyre në lidhje me monitorimin e zbatimit të Konventës CEDAW dhe rekomandimeve të Komitetit për Shqipërinë si dhe përgatitjen e raporteve hije/alternative përpara Komitetit CEDAW. Në fokus të veçantë, manuali do të shërbejë OJF-ve për të përgatitur raportet hije/alternative në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të Komitetit në këtë fushë.

1.2 Çfarë është CEDAW?

CEDAW është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të Njeriut që ka si qëllim të eliminojë të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe të promovojë të drejta të barabarta të grave dhe burrave në të gjithë botën. Shtetet palë janë të detyruara të marrin masa legjislative, gjyqësore administrative dhe çdo masë tjetër të nevojshme, për të ndaluar diskriminimin dhe për të promovuar barazinë midis burrave dhe grave. Ndryshe kjo Konventë quhet **Konventa e Grave**.



1.3 Cilat janë fushat që mbulon Konventa CEDAW?

Për të organizuar sa më mirë përmbajtjen e raportit hije ose alternative, çdo OJF duhet të njihet fillimisht me përmbajtjen e Konventës dhe fushat që ajo

mbulon. Në mënyrë skematike konventa CEDAW është e organizuar si më poshtë¹:

<p>PJESA I: Kuadri i përgjithshëm substancial i Konventës Diskriminimi (Neni 1) Masat politike të Shteteve (neni 2) Garantimi i të Drejtave dhe lirive themelore të Njeriut (Neni 3) Masat e Veçanta (Neni 4) Paragjykimi dhe Stereotipat gjinore (Neni 5)</p>	<p>PJESA IV: Fushat substanciale të Konventës Ligji (Neni 15) Martesa dhe Jeta familjare (Neni 16)</p>
<p>PJESA II: Fushat substanciale të Konventës Trafikimi dhe Shfrytëzimi i Prostitucionit (Neni 6) Jeta Politike dhe Publike (Neni 7) Përfaqësimi (neni 8) Shtetësia (Neni 9)</p>	<p>Pjesa V: Komiteti CEDAW dhe procedurat e mbrojtjes Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Neni 17) Raportet Kombëtare (Neni 18) Rregullat procedurale (Neni 19) Mbledhjet e Komitetit (Neni 20) Raportet e Komitetit (Neni 21) Roli i Agjencive të Specializuara (Neni 22)</p>
<p>PJESA III: Fushat substanciale të Konventës Arsimi (Neni 10) Punësimi (Neni 11) Shëndeti (neni 12) Përfitimet ekonomike dhe Sociale (Neni 13) Gratë në zonat rurale (Neni 14)</p>	<p>Pjesa VI: Administrimi dhe Interpretimi i Konventës Efekti mbi traktatet e tjera (Neni 23) Zotimi i Shteteve Palë (Neni 24) Administrimi i Konventës (Nenet 25-30)</p>


1.4 A ka detyrime për shtetin shqiptar në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, që burojnë nga Konventa CEDAW?

Dhuna ndaj Grave nuk është pjesë e fushave substanciale të mbrojtura nga Konventa CEDAW. Megjithatë, Dhuna ndaj grave është e parashikuar në Rekomandimet e Përgjithshme të mëposhtme të miratuara nga Komiteti i Eliminimit të Diskriminimit ndaj Grave:

- Rekomandim i Përgjithshëm Nr.12 i Komitetit:
Dhuna ndaj Grave (1989)
- Rekomandim i Përgjithshëm Nr.19 i Komitetit:
Dhuna ndaj Grave (1992)

1 Global Alliance Against Traffic in Women. (2011) " A toolkit for reporting to CEDAW on trafficking in women and exploitation of migrant women workers", fq 8.

- Rekomandim i Përgjithshëm Nr. 35 i Komitetit:
Dhuna me bazë gjinore kundër grave (2017)²



Për t'u mbajtur mend: Komiteti CEDAW në mënyrë specifike në rekomandimet e mësipërme detyron Shtetet të eliminojnë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, të cilat drejtohen ndaj grave vetëm sepse ato janë gra ose prekin gratë në mënyrë disproporcionale. Çështje të adresimit të dhunës ndaj grave nga shteti shqiptar kanë zënë një vend të rëndësishëm në Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit CEDAW të vitit 2016³. Megjithatë, nëse ju kërkon të përgatisni një raport hije/alternativ në lidhje me Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri, raporti mund të organizohet në mënyrë të tillë që të përfshijë rekomandimet e Komitetit CEDAW në fushën specifike, por gjithashtu mund të alternohet edhe me nene të tjera të Konventës që kanë lidhje me dhunën me bazë gjinore. (p.sh. Shëndeti/ Arsimi/ Pronësia / Jeta familjare/Fuqizimi ekonomik). Referimi në Vërejtjet Përmbyllëse më të fundit të Komitetit CEDAW (aktualisht të vitit 2016) dhe Rekomandimet e Përgjithshme është i rëndësishëm.

1.5 Cili është roli që luajnë organizatat e shoqërisë civile në aktivitetin e Komitetit CEDAW?

Organizatat jo-fitimprurëse luajnë një rol të rëndësishëm në kuadër të zbatimit efektiv të Konventës CEDAW. Ato mund të bëhen pjesë aktive e mekanizmit të Konventës CEDAW përmes ushtrimit të secilës prej kompetencave të mëposhtme:

- Promovojnë dhe monitorojnë zbatimin e Konventës CEDAW, Protokollit të saj Opsional dhe Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW;

2 Përmbajtjen e këtyre rekomandimeve mund ta gjeni tek: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/index.html>

3 Vërejtjet Përmbyllëse janë të miratura nga Komiteti në sesionin e tij të 64 të mbajtur në datat 4-22 Korrik 2016. Përmbajtjen e plotë të materialit mund ta konsultoni tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=En

- I japin Komitetit CEDAW informacion të besueshëm në lidhje me situatën e të drejtave të grave në shtetin e tyre, të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit të tij; *Referuar në Rregullin 47, të Rregullave të Procedurave të Komitetit CEDAW, parashikohet se “Përfaqësues të OJF-ve mund të ftohen nga Komiteti për të paraqitur informacione me gojë ose me shkrim ose dokumente që lidhen me aktivitetet e Komitetit në kuadrin e Konventës, në takimet e Komitetit ose në takimet e grupit të punës para sesionit”*⁴. Informacioni i marrë nga OJF-të ndihmon Komitetin të zhvillojë një dialog konstruktiv me shtetin;
- Përgatisin raporte alternative ose hije ose/dhe informacione me gojë në takimet e grupit të punës para sesionit. Këto raporte lidhen me informacionin e marrë mbi zbatimin e disa ose të gjitha dispozitave të Konventës ose temave specifike që fokusohen në boshllëqet e zbatimit të Konventës ose Vërejtjeve Përmblyëse të Komitetit CEDAW. Ky informacion shërben për përgatitjen e Listës së çështjeve dhe Pyetjeve, e cila përbëhet nga 30 pyetje.
- Përgatisin raporte alternative ose hije ose/dhe informacione për takimet e Komitetit, bëjnë prezantim me gojë gjatë sesionit të Komitetit dhe janë prezentë si vëzhguese gjatë shqyrtimit të raportit të shtetit nga Komiteti CEDAW;
- Mund të ofrojnë informacione alternative për Komitetin gjatë takimeve informale të drekës me anëtarët e Komitetit. Këto takime janë mbajtur zakonisht një ditë para shqyrtimit të raportit të shtetit nga Komiteti;
- Mund të paraqesin raporte alternative/hije në kuadrin e procedurës Follow-up, duke dhënë informacion mbi masat e ndërmarra nga shteti në zbatim të rekomandimeve të zgjedhura nga Komiteti CEDAW;
- Mund të paraqesin raporte alternative/hije në lidhje me raportet e veçanta të kërkuara nga Komiteti, sipas nenit 18 (1) (b) të Konventës dhe Rregullave të Procedurës;
- Të paraqesin inpute në lidhje me rekomandimet e përgjithshme të Komitetit dhe të përdorin këto rekomandime në përpjekjet e tyre advokuese;
- Mund të përdorin Konventën dhe procedurat në kuadrin e Protokollit Opsional;
- OJF-të mund të mbështetin viktimat ose grup viktimash të cilave u janë cenuar të drejtat e njeriut, duke paraqitur komunikime/ankime para Komitetit në kuadrin e procedurës së komunikimit. OJF-të mundet gjithashtu që në situata të caktuara, të ofrojnë informacion të besueshëm mbi dhunime të rënda ose sistematike të të drejtave njerëzore të grave, që lidhen me mandatin e Komitetit të kryejë një hetim në kuadrin e Protokollit Opsional;

4 *Rregullat e Procedurave të Komitetit CEDAW mund t'i konsultoni tek http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/Part%20of%20HRI_GEN_3_Rev-3_7080_E.pdf*

- Mund të kontribuojnë edhe nëpërmjet video konferencave, kur për arsye logjistike dhe financiare nuk është e mundur që OJF-të të marrin pjesë në sesionin e Komitetit⁵.

Për sa më sipër OJF-të mund ta shndërrojnë Konventën në një instrument për fuqizimin e të drejtave të grave përmes monitorimit, advokacisë dhe lobimit për zbatimin e Konventës, Vërejtjeve Përmblyëse dhe rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit CEDAW.

2. MONITORIMI I KONVENTËS CEDAW DHE REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT CEDAW

2.1 Pse është e rëndësishme për OJF-të të monitorojnë zbatimin e Konventës CEDAW dhe rekomandimet e Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore?

Zbatimi i detyrimeve të parashikuara në Konventë apo zbatimi i rekomandimeve të Komitetit është detyrë e shtetit shqiptar. OJF-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes së tyre për shtetin në përmbushjen efektive të detyrimeve konventore. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të parashikuara në Konventën CEDAW në lidhje me dhunën me bazë gjinore i ndihmon organizatat që të njihen nga afër me situatën reale të grave viktime të dhunës dhe faktorët që kanë çuar në rritjen e përmasave të dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, me qëllim që të propozojnë masat për përmirësimin e situatës së tyre. Pjesëmarrja e tyre në procesin monitorues i ndihmon gjithashtu OJF-të të paraqesin raporte sa më të plota përpara Komitetit CEDAW gjatë sesioneve të raportimeve.

Roli i OJF-ve në procesin e monitorimit në fushën e dhunës me bazë gjinore mund të evidentohet në lidhje me:

- Monitorimin e zbatimit nga shteti shqiptar të detyrimeve që parashikon Konventa CEDAW në lidhje me diskriminimin e grave dhe Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 i Komitetit;
- Monitorimin e përmbushjes së Rekomandimeve të Komitetit CEDAW për shtetin shqiptar pas rishikimit, në fushën e dhunës me bazë gjinore.

Për të arritur këto qëllime është e rëndësishme për organizatat që të krijojnë mjetet e duhura për monitorimin e zbatimit të Konventës të cilat përqendrohen kryesisht në mbledhjen dhe analizën e të dhënave në fushën e dhunës me bazë gjinore. Konventa në vetvete dhe Rekomandimi i përgjithshëm nr.35 i Komitetit janë dy mjete të rëndësishme ku OJF-të mund të referohen gjatë procesit të monitorimit me qëllim që t'i kërkojnë qeverisë së shtetit shqiptar marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e të drejtave të grave në këtë fushë. Gjithashtu përmes mekanizmave monitorues, OJF-të jo vetëm mund të nxisin në mënyrë të vazhdueshme shtetin shqiptar për zbatimin efektiv të detyrimeve që parashikon Konventa, por edhe të ndihmojnë në përmbushjen e tyre duke i ofruar autoriteteve

⁵ Shih për më tepër "IWRRAW Asia Pacific "From Global to Local:Orientation on the Convention on the Elimination of All Forms of discrimination against Women", Geneva, 16-29 January 2010, fq 6.

shtetërore përgjegjëse ekspertizën e tyre në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Kryerja me sukses e procesit të monitorimit i hap rrugën OJF-ve për t'iu drejtuar Komitetit CEDAW me raporte hije/alternative me qëllim sjelljen në vëmendjen e Komitetit të rezultateve të dala nga procesi i monitorimit dhe propozimin e zgjidhjeve për përmirësimin e situatës.⁶

Materiali në vazhdim do të ofrojë njohuri për çdo OJF të interesuar në lidhje me:

- Rekomandimet e Komitetit CEDAW në fushën e dhunës me bazë gjinore,
- Treguesit që do të përdorin OJF-të për të matur zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komitetit nga shteti shqiptar,
- Burimet nga të cilat OJF mund të marrin informacion për matjen e tregueseve
- Metodat që ato mund të përdorin për të marrë informacion në lidhje me përmbushjen ose jo të rekomandimeve të Komitetit nga shteti.

2.2 Cilat janë fazat e monitorimit dhe ku mund të njihen OJF-të me detyrimet që ka shteti shqiptar për të përmbushur në bazë të Konventës?

Procesi i monitorimit të Konventës CEDAW nga OJF-të mund të ndahet në dy faza:

- *Faza e parë: Monitorimi i zbatimit të neneve të Konventës dhe Rekomandimeve të Përgjithshme të Komitetit në fusha specifike.*
- *Faza e dytë: Monitorimi i zbatimit të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW pas sesionit të rishikimit.*

Për t'u njohur me detyrimet që ka shteti shqiptar për të përmbushur (të cilat do të bëhen objekt monitorimi nga ana juaj) është e rëndësishme që OJF-të të lexojnë paraprakisht dispozitat që përmban Konventa CEDAW, rekomandimet e përgjithshme të Komitetit, Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit për shtetin si dhe Rekomandimet e Komitetit brenda VP.⁷

Në këtë kuadër, nga përvoja që ka pasur QNL si organizatë është konstatuar se kuptimi i mirë i dispozitave të Konventës dhe i terminologjisë që ajo përmban është parësore. Shpesh pyetjet që drejtohen nga anëtarët e Komitetit dhe reporterët janë me fokus mjaft të specializuar dhe për një çështje të caktuar. Ngatërimi i koncepteve të con në përgjigjen e gabuar.

Kështu, p.sh., në një rast të konstatuar nga QNL ndodhi që një nga përfaqësuesit e shteteve nuk kuptonte mirë dallimet midis termave të lidhur me abortin. Në vend që të përgjigjej për abortin e detyruar, ai përgjigjej në tërësi për të gjitha politikat e qeverisë që lidheshin me abortin në përgjithësi.

6 Shih Luka.B (2015) "Guideline for monitoring of implementation of the Convention on the Elimination of All", fq.18-20, Helsinki Citizens' Assembly

7 Përmbajtjen e materialeve të mësipërme mund ta konsultoni tek <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>.

Në fushën e dhunës me bazë gjinore OJF-të duhet të monitorojnë zbatimin e detyrimeve të shtetit shqiptar që burojnë nga rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 i Konventës CEDAW, dispozitat substanciale të Konventës që lidhen me dhunën me bazë gjinore (nenet 1,7,10-14) si dhe Rekomandimet e Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore. Të dhënat në lidhje me këto detyrime mund t'i gjeni tek <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/index.html>

2.3 Cilat janë disa nga treguesit që mund të përdoren nga OJF-të në monitorimin e standardeve që burojnë nga CEDAW në lidhje me adresimin e dhunës ndaj grave?

Një nga mënyrat më efektive të monitorimit të zbatimit të detyrimeve të Konventës është përcaktimi i treguesve nga OJF-të për të matur plotësimin e detyrimeve nga ana e shtetit. Është e rëndësishme që treguesit të jenë specifikë, të matshëm, të arritshëm brenda një periudhe të caktuar si edhe të përshtatshëm në lidhje me situatën në të cilën ndodhet shteti nën monitorim. Tabela në vijim ka si qëllim t'i orientojë OJF-të në lidhje me disa tregues që mund të përdorin për monitorimin e plotësimit të detyrimeve ligjore, ekzekutive dhe gjyqësore nga shteti shqiptar në kuadër të Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.35 të Komitetit.⁸

Detyrimet për shtetin:	Çfarë duhet të monitoroni?
<p>Në nivel legjislativ shteteve u kërkohet që të miratojnë një kuadër ligjor efektiv që ndalon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave duke harmonizuar ligjin e brendshëm me Konventën.</p>	<p>Për të monitoruar këtë detyrim ju mund të mblidhni të dhëna në lidhje me këto çështje:</p> <p>A ofron legjislacioni në fuqi mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore?</p> <p>Në se po, për cilat forma të dhunës me bazë gjinore, legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtje? A është përkufizimi i diskriminimit sipas ligjit shqiptar në përputhje me parashikimet e Konventës? A e përfshin përkufizimi i diskriminimit dhunën me bazë gjinore?</p> <p>A përmban ligji shqiptar dispozita të ndjeshme nga pikëpamja gjinore?</p> <p>Sa efektive janë ligjet që adresojnë format e dhunës ndaj grave?</p> <p>A janë të parashikuara në ligj sanksionet dhe dëmshpërblimi i grave në rastet e dhunës ndaj tyre?</p> <p>A janë të aksesueshëm nga gratë ligjet që adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe a ka të dhëna në lidhje me aksesin e tyre në këto ligje?etj.</p>

8 Committee on the Elimination of Discrimination against Women " General recommendation No. 35 on gender-based violence against women, updating general recommendation No. 19", fq.10-11.

<p>Në nivel ekzekutiv shtetet palë janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e mekanizmave të monitorimit të dhunës me bazë gjinore, për krijimin e shërbimeve të aksesueshme dhe të përbalueshme për viktimat e dhunës, për eliminimin e praktikave institucionale që rezultojnë në dhunë me bazë gjinore etj.</p>	<p>Për të monitoruar këtë detyrim ju mund të mbledhni të dhëna në lidhje me këto çështje:</p> <p>A ka ngritur qeveria shqiptare mekanizma të monitorimit të dhunës me bazë gjinore? A ka planifikuar për këto mekanizma buxhet të mjaftueshëm?</p> <p>A buxhetohet në buxhetin e shtetit dhuna me bazë gjinore? Po në nivel lokal?</p> <p>A garanton shteti shqiptar ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje? A ofrohet shërbim ligjor falas për to edhe në nivel lokal?</p> <p>A ka mjaftueshëm strehëza dhe shërbime të tjera mjekësore dhe sociale për të rehabilituar gratë viktimat të dhunës?</p>
	<p>A ka shteti programe rehabilitimi për viktimat e dhunës me bazë gjinore?</p> <p>Çfarë masash ka marrë qeveria për të parandaluar ngacmimin seksual?</p> <p>A janë të ngritura linjat e këshillimit për viktimat e dhunës në të gjithë territorin? Si funksionojnë ato? A janë të aksesueshme 24/7? Etj.</p>
<p>Në nivel gjyqësor, të gjitha organet gjyqësore janë të detyruara të mos përfshihen në asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit ose dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe të zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha dispozitat e ligjit penal që ndëshkojnë këtë dhunë, duke siguruar që të gjitha procedurat ligjore në rastet që përfshijnë raportimet për dhunë me bazë gjinore kundër grave janë të paanshme, të drejta dhe të pandikuara nga stereotipet gjinore ose interpretimi diskriminues i dispozitave ligjore.</p>	<p>A merren seriozisht ankesat e grave në lidhje me dhunën dhe nëse po a hetohen ato në mënyrë efektive?</p> <p>Çfarë vendimesh janë marrë nga gjykatat në lidhje me dhunën në familje? Sa urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm Mbrojtje janë lëshuar nga Gjykata, gjatë periudhës objekt monitorimi?</p> <p>Sa efektive kanë qenë UM dhe UMM? Cila është shkalla e zbatimit të tyre? A janë marre masa në rast moszbatimi?</p> <p>A përmbajnë vendimet e gjyqtarëve referime të Konventës CEDAW dhe rekomandimeve të përgjithshme të saj?</p> <p>Si i trajtojnë policia dhe autoritetet gjyqësore gratë që raportojnë dhunën seksuale dhe i drejtohen gjykatës?</p> <p>A janë procedurat e ankimit të thjeshta, të aksesueshme dhe të shpejta për viktimat e dhunës me bazë gjinore? Etj.</p>

2.4 Cilat janë disa nga burimet që mund të shfrytëzojnë OJF-të për të marrë informacion në lidhje me vlerësimin e treguesëve për adresimin e dhunës me bazë gjinore?

Mbledhja e të dhënave të sakta dhe të besueshme është një nga sfidat më të cilat përballen organizatat gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të konventës dhe hartimit të raporteve hije/alternative. Pamjaftueshmëria e burimeve qeveritare për të mbledhur të dhëna është e njohuZr nga OJF-të. Megjithatë, ekzistojë katër burime kryesore të informacionit dhe të dhënave që mund të shfrytëzohen nga OJF-të në varësi të treguesëve që kërkojnë të matin:

- Të dhëna të marra nga dokumentet zyrtare;
- Të dhëna të prodhuara si rezultat i studimeve të kryera nga kërkues të pavarur ose nga universitetet;
- Të dhëna të marra nga organizata ndërkombëtare ose nga OJF ndërkombëtare;
- Të dhëna të prodhuara nga vetë OJF-të si rezultat i kërkimeve të kryera prej tyre ose aktivitetit të tyre.

Shumica e OJF-ve të konsultuara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare kanë evidentuar si problem mungesën e resurseve për të kryer kërkime të vetat. Për këtë arsye është më se e domosdoshme asistencë teknike dhe krijimi i kapaciteteve për të adresuar këtë boshllëk në punën e OJF-ve, në mënyrë që të prodhojmë të dhëna më të sakta e të besueshme jo vetëm në kuadër të raportimit përpara Komitetit CEDAW, por edhe për raportimet në nivel kombëtar.

Rekomandohet që OJF-të të forcojnë lidhjet me institucionet kërkimore (universitetet) dhe kërkuesit shkencorë me qëllim që të mbledhin të dhëna më të plota e të sakta. Gjithashtu OJF duhet të ushtrojnë presion tek qeveria dhe autoritetet lokale për krijimin e një sistemi të plotë të dhënash që përfshin tregues të matshëm si dhe të dhëna të ndarë nga pikëpamja gjinore në të gjitha sektorët, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Edhe vetë OJF-të kur kryejnë studime duhet të ndajnë të dhënat sipas seksit, origjinës etnike, zonave urbane dhe rurale, moshës, etj.

Po kështu referimi në të dhënat statistikore zyrtare është mjaft i rëndësishëm dhe lehtëson punën e organizatave jofitimprurëse gjatë procesit të monitorimit të zbatueshmërisë së Konventës CEDAW nga shteti shqiptar. Këto të dhëna mund të konsultohen nga OJF sipas treguesve të monitorimit të hartuara prej tyre në lidhje me periudhën gjatë të cilës do të kryhet monitorimi. Megjithatë, vlen për t'u përmendur që të dhënat statistikore zyrtare të dhtetit shqiptar në fushën e dhunës me bazë gjinore kanë qënë mjaft të cunguara. Për këtë, OJF-të, në shumë raste, kanë mbledhur të dhëna statistikore të vetat, por që mbeten si të dhëna alternative.

Në varësi në llojit të treguesit të përcaktuar për adresim e dhunës me bazë gjinore, OJF-të mund të hartojnë fillimisht një listë të burimeve që mund t'iu shërbejnë për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme ose listës së pyetjeve objekt monitorimi.

Kështu për shembull: nëse doni të monitoroni miratimin e ligjeve që adresojnë dhunën me bazë gjinore, si burim mund të përdorni gazetën zyrtare, website të parlamentit/ Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, etj.

Nëse doni të monitoroni përputhjen e ligjit të brendshëm me Konventën CEDAW, si burim do t'iu shërbejë Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Konventa CEDAW.

Nëse doni të monitoroni kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në çështjet që gjykohen në lidhje me ëëë dhunën ndaj grave, përqindjen e rasteve të zgjidhura, sanksionet e dhëna në raste të tilla, si burime mund t'iu shërbejnë statistikën zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, raporte dhe statistika të gjykatave, raporte dhe publikime të organizatave jo qeveritare që monitorojnë gjykatat në përgjithësi dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në rastet e dhunës ndaj grave në veçanti, raporte të OSBE-së në lidhje me monitorimin e gjyqësorit, etj.

2.5 Çfarë metodash mund të përdoren nga OJF-të për monitorimin e zbatimit të Konventës nga ana e shtetit?

Me qëllim për të lehtësuar punën e organizatave në procesin e monitorimit, ky manual hedh dritë edhe mbi disa prej metodave që mund të përdorin OJF-të për të mbledhur të dhënat ose informacionin e nevojshëm për to.

Kështu, përveç intervistave, sondazheve online për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit OJF-të mund të përdorin gjithashtu mundësinë e organizimit të takimeve me fokus grupe, hartimin e pyetësorëve si dhe kërkesat drejtuar autoriteteve publike kompetente për marrjen e informacionit.⁹

Në rastin e kërkesave për të marrë informacion nga autoritetet publike, ju mund të kërkonit informacion nga çdo organ ligjor, ekzekutiv, administrativ, gjyqësor që e disponon ose që ka autoritetin për ta ofruar. Kërkesa për të marrë informacion duhet të bazohet në Ligjin 119/2014

“Për të Drejtën e Informimit”. Lexoni paraprakisht përmbajtjen e ligjit në mënyrë që të respektoni kriteret procedurale për hartimin e kërkesës.¹⁰

Sipas ligjit të sipërcituar, kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Ajo duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.¹¹ Në çdo rast autoriteti publik ka detyrimin për t’iu pajisur me informacionin që ju kërkonit brenda 10 ditëve pune nga marrja e kërkesës nga autoriteti publik, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm të cilit ju mund t’i referohemi përcakton një afat ndryshe¹²

Tabela më poshtë ka si qëllim të orientojë OJF-të në lidhje me formatin e kërkesës që ato mund të përdorin për të marrë informacion nga autoritetet publike.

9 Luka.B (2015) “Guideline for monitoring of implementation of the Convention on the Elimination of All”, fq.58, Helsinki Citizens’ Assembly Forms of Discrimination against Women

10 Përmbajtjen e Ligjit Nr 119-2014 “Për të drejtën e informimit” mund ta konsultoni tek http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/160-2014.pdf

11 Neni 11/1/4 i Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

12 Për më tepër në lidhje me afatet për marrjen e informacionin nga autoriteti public sipas kërkesës së bërë nga ju shih Nenin 15 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

2.6 Kërkese për informacion ¹³

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/2018_ Nënshkrimi:
---------------------------------------	---	----------------------------------

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar
<p>I/E nderuar Z/Zj. _____ (Koordinator për të Drejtën e Informimit të Shkollës së Magjistraturës)</p> <p>Bazuar në Nenin 11 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” kërkojmë nga ana juaj të na jepni informacionin e mëposhtëm:</p> <p>1. Është trajnimi mbi Konventën CEDAW pjesë integrale e programit të trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Shkolla e Magjistraturës?</p> <p>Nëse po, ju lutemi të na jepni informacion në lidhje me:</p> <p>1.1 Sa herë në vit organizohen trajnime me këtë temë?</p> <p>1.2 Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë trajnuar gjithsej në lidhje me zbatimin e Konventës në Shqipëri?</p> <p>1.3 Cilët ishin trajnuesit e përfshirë në këto trajnime?</p> <p>1.4 A keni informacion nëse gjyqtarët ose prokurorët, pas trajnimit, referonin Konventën në vendimet e tyre?</p> <p>Në pritje të një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj, Duke iu falenderuar për bashkëpunimin,</p>

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Në formë elektronike në adresën e email-it _____

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Kujdes!


- Adresa dhe kontaktet e autoritetit publik mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

13 Model i unifikuar i kërkesës për informacion në bazë të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

3. PROCESI I RISHIKIMIT TË KONVENTËS NGA KOMITETI CEDAW DHE PARAQITJA E RAPORTEVE HIJE/ALTERNATIVE.

3.1 Si është i organizuar procesi i rishikimit dhe cilat janë hapësirat e pjesëmarrjes së OJF-ve në këtë proces?

PROCESI I RISHIKIMIT¹⁴



¹⁴ Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A toolkit for reporting to CEDAW on trafficking in women and exploitation of migrant women workers", fq 14.

3.2 Pse është e rëndësishme për OJF-të që të përfshihen në procesin e rishikimit?

Ndërkohë që Komiteti merr informacion nga Shteti në lidhje me zbatimin e Konventës, është po aq e rëndësishme edhe informacioni që organizatat me ekspertizë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave mund t'i japin Komitetit. Kjo, pasi OJF-të mund të vlerësojnë në mënyrë kritike se si masat e marra nga shteti mund të ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore. OJF-të i japin gjithashtu Komitetit informacione shtesë në lidhje me situatën e grave në vendin objekt rishikimi, të cilat mund të mos jenë dhënë apo njohur nga shtetet. Komiteti vlerëson rolin e OJF-ve si mjaft të rëndësishëm në procesin e rishikimit dhe kërkon prej tyre t'i drejtojnë atij çështjet më shqetësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore në vend. Gjithashtu pjesëmarrja në procesin e rishikimit i jep mundësi OJF-ve të zgjerojnë të kuptuarit e Komitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore, të promovojnë marrjen e masave efektive kundër dhunës ndaj grave dhe si rezultat të sigurojnë që procesi i rishikimit të garantojë efektivisht përmirësimin e të drejtave të grave dhe situatën e grave të dhunuara në vend.

Për sa më sipër është e rëndësishme që sa më shumë organizata që punojnë me grupe të ndryshme grash dhe që kanë njohuri specifike në fusha të caktuara të mbrojtjes së të drejtave të tyre, të përfshihen në procesin e rishikimit dhe të integrojnë njohuritë dhe eksperiencën e tyre në raportet që ato mund t'i paraqesin Komitetit.

Në sesionet e mëparshme të rishikimit të shtetit shqiptar disa prej OJF që mbrojnë të drejtat e grave janë bërë pjesë aktive e procesit të rishikimit duke paraqitur raporte hije për Komitetin. Të tilla kanë qenë raportet hije të paraqitura nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Rrjeti i Fuqizimit të Grave në Shqipëri, Rrjeti kundër trafikimit të grave dhe dhunës ndaj grave, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Qendra për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri dhe organizata të tjera.

Objektivat kryesore të pjesëmarrjes së OJF-ve në procesin e rishikimit janë:

- Rrit ndërgjegjësimin e Komitetit në lidhje me çështjet kyç dhe shqetësimet që lidhen me zbatimin e Konventës nga Shtetet.
- Lobon me Komitetin për të ngritur çështjet kyç dhe pyetjet specifike me shtetin gjatë dialogut interaktiv
- Influencon Vërejtjet Përmblylëse dhe Rekomandimet duke promovuar marrjen e masave dhe strategjive kundër dhunës ndaj grave.

(Burimi: Global Alliance Against Traffic in Women.(2011)

3.3 Çfarë është sesioni i para-rishikimit dhe cili është roli i përfshirjes së OJF-ve në këtë proces?

Sesioni i para-rishikimit mbahet disa muaj përpara mbajtjes së sesionit zyrtar të rishikimit të shtetit. Në këtë fazë grupi i punës i Komitetit takohet për rishikuar raportin e dërguar nga shteti dhe çdo informacion shtesë që i është dërguar Komitetit përpara sesionit. Gjatë këtij takimi, grupi i punës identifikon boshllëqet në informacion dhe i dërgon qeverisë një listë të pyetjeve dhe çështjeve për t'iu përgjigjur përpara rishikimit formal. Kjo listë mund të përfshijë fushat të cilat Shteti nuk i ka raportuar ose pyetje në lidhje me masat që janë marrë. Lista e çështjeve

është mjaft e rëndësishme në rrugën e procesit të rishikimit pasi shërben si një tregues në lidhje me fushat më problematike që shqetësojnë gratë.¹⁵

Faza e para-rishikimit përcakton drejtimin, tonet dhe çështjet për dialog midis Komitetit dhe qeverisë gjatë sesionit të rishikimit. Për këtë arsye, rekomandohet që OJF-të të jenë sa më aktive gjatë gjithë kësaj faze. OJF-të mund t'i dërgojnë informacione me shkrim Zyrës së Komisionerit të Lartë të Drejtave të Njeriut përmes një raporti hije ose një informacioni të shkurtër me shkrim, ku të nënvizojnë çështjet kyç që Komiteti duhet të marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së Listës së çështjeve. OJF-të mund të bëjnë gjithashtu një prezantim me gojë të këtyre çështjeve tek anëtarët e Komitetit në fillim të Punës në Grupin përpara Sesionit.

Kujdes!

Informacioni që do t'i jepni Komitetit në këtë fazë duhet të përmbajë:

- Çështjet më kritike/shqetësuese me të cilat po përballen gratë (përfshirë gratë e dhunuara) në Shtetin tuaj;
- Çfarë mungon në raportin e Qeverisë;
- Për cilat çështje do të donit ju që Komiteti të pyeste Qeverinë .

*Lista e çështjeve dhe pyetjeve nuk duhet të jetë shumë e gjatë ose e komplikuar. Ju duhet të jeni sa më konkretë, për të ndihmuar grupin e punës për të kuptuar se çfarë po ndodh në vendin tuaj. Nëse ju e keni hartuar ndërkohë një raport hije për Komitetin, atëherë mund të dërgoni një draft të tij bashkë me një listë me çështjet më me rëndësi dhe boshllëqet në raportin e shtetit. **Anëtarë të Komitetit i kanë vlerësuar në disa raste më të nevojshme listat e çështjeve se sa vetë raportet shteruese mbi këto çështje.***

3.4 Çfarë duhet të kenë parasysh OJF-të, nëse mund të marrim pjesë gjatë sesioneve të rishikimit ?

Çdo OJF mund të marrë pjesë në sesionet e rishikimit përmes:

1. Prezantimeve me gojë: Komiteti dëgjon informacionin direkt nga OJF-të, në lidhje me Shtetet subjekt rishikimi, në formën e prezantimeve me gojë. Çdo OJF ka në dispozicion 10-20 minuta për t'i adresuar Komitetit informacionin e nevojshëm. Kjo është një mundësi e mirë për çdo OJF që të nënvizojë dhe të rrisë vëmendjen e Komitetit mbi çështjet më problematike siç ajo i ka detajuar në raportet hije, të identifikojë pyetjet specifike që Komiteti CEDAW mund të ngrejë gjatë rishikimit të raportit të shtetit si dhe të propozojë rekomandime/zgjidhje të problemeve në lidhje me zbatimin e Konventës.

¹⁵ Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A TOOLKIT FOR REPORTING TO CEDAW ON TRAFFICKING IN WOMEN AND EXPLOITATION OF MIGRANT WOMEN WORKERS", fq 17.

Kujdes!

Koha e prezantimit është e limituar. Për këtë arsye ju duhet të mendoni paraprakisht për natyrën dhe përmbajtjen e prezantimit që të jeni sa më efektivë. Jini preciz dhe rigoroz në identifikimin e çështjeve shqetësuese në lidhje me dhunën ndaj grave në vend dhe ofroni grave. Po kështu jini të përgatitur që t'i përgjigjeni pyetjeve të Komitetit pas prezantimit tuaj.¹⁶

Me qëllim që prezantimi i OJF-ve përpara Komitetit të jetë sa më efektiv brenda kohës në dispozicion, është e sugjerueshme të merren parasysh disa nga rekomandimet e mëposhtme:

- Diskutoni mbi çështjet kritike të raportit alternativ/hije;
- Identifikoni pyetje që Komiteti mund të ngrejë gjatë shqyrtimit të raportit të shtetit;
- Prezantoni çdo informacion të ri që nga paraqitja e raportit me shkrim ose nga paraqitja e raportit ose informacionit për grupin e punës para sesionit;
- Propozoni rekomandime/zgjidhje për problemet e hasura në zbatim të Konventës;¹⁷

2. Takime informale (Informal lunchtime briefing session): Ju mund të organizoni dhe të ftoni anëtarët e Komitetit në një sesion të shkurtër informimi. Kjo është një mundësi për OJF-të që të informojnë anëtarët e Komitetit mbi çështjet urgjente/ kyç dhe për Komitetin për të sqaruar çështje të ndryshme që lidhen me informacionin e dhënë përmes raporteve të shtetit ose OJF-ve. Edhe pse anëtarët e Komitetit nuk janë të detyruar të marrin pjesë, shumica merr pjesë në këto takime, të paktën për një kohë të shkurtër. Përmes këtyre takimeve OJF-të kanë mundësi gjithashtu të llobojnë me anëtarët e Komitetit për të ngritur çështje të veçanta ose për t'i drejtuar pyetje specifike shtetit gjatë dialogut interaktiv. Kjo mund të bëhet me gojë ose përmes informacioneve me shkrim.

Për t'u mbajtur mend:

Në identifikimin e çështjeve që do të adresoni në takimet informale shihni edhe njëherë ato që keni ngritur si më shqetësuese në Raportin Hije/Alternativ si dhe Listën e çështjeve të identifikuar më parë nga Komiteti. Sigurohuni të jeni të përgatitur me informacionin më të përditësuar, jo vetëm me çështjet e ngritura nga Komiteti por edhe me përgjigjet e Shtetit, të cilat publikohen në web e Komitetit CEDAW. Organizoni prezantimin tuaj që të mos zgjasë më shumë se 5-10 minuta. Gjithashtu kini parasysh që interpretimi përgjithësisht nuk është i lejuar në këto takime informale. Nëse nuk i përgjigjeni dot të gjitha pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Komitetit, sigurojini ata që do t'i dërgoni informacion në formë të shkruar mbi këto pyetje. Këto takime janë private dhe vetëm anëtarët e Komitetit kanë mundësi që të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime nga OJF-të. Me qëllim që takimet informale me anëtarët e Komitetit të jenë të suksesshme rekomandohet të merren parasysh këshillat e mëposhtme:

- Identifikoni një moderator dhe 2-3 folës, nga pjesëmarrësit, përfaqësues të OJF-ve;

16 International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), Participation in the CEDAW reporting process: NGO interventions during and after the CEDAW session, April 2010

17 International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), Participation in the CEDAW reporting process: NGO interventions during and after the CEDAW session, April 2010

- Kujto që anëtarët e Komitetit dëshirojnë ta përdorin këtë mundësi për pyetje dhe sqarime;
 - Sigurohuni që keni listën emërore të anëtarëve të Komitetit;¹⁸
- 3.** Takime një nga një (One to one): Ndërkohë që Anëtarët e Komitetit janë në sesion në pjesën më të madhe të ditës, takimet një nga një mund të organizohen përpara, pas dhe ndonjëherë edhe gjatë sesionit. Këto takime i ofrojnë çdo OJF-je mundësinë për të rritur ndërgjegjësimin e anëtarëve të Komitetit në lidhje me çështjet kritike që kanë nevojë për t'u adresuar brenda vendit. Takimet duhet të organizohen nga OJF-të dhe të përfshijnë Raportuesin e Shtetit dhe anëtarët e Komitetit që kanë interes në çështjet e ngritura.¹⁹ (p.sh. anëtarët e Komitetit që kanë interes në të drejtat e grave të dhunuara, eliminimin e dhunës me bazë gjinie, çështje të shërbimit ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, etj.).

Për t'u mbajtur mend:

Edhe në këtë rast sigurohuni që keni një listë të anëtarëve të Komitetit për t'u njohur me emrat e tyre. Ju nuk keni nevojë për lehtësues për të takuar anëtarët e Komitetit. Përpara ose pas sesioneve mund të prezantoheni me ta dhe t'i pyesni nëse kanë kohë të takohen me ju. Nëse nuk kanë kohë të lirë në moment, mund t'i ftoni për drekë ose çaj në çdo moment tjetër të përshtatshëm për ta. Ndërkohë pas rishikimit të raportit të shtetit përgatitni një dokument të shkruar në lidhje me çështjet që ju do të donit të përfshiheshin në Vërejtjet Përmbyllëse dhe dorëzoheni tek anëtari i Komitetit që do të jetë Raportues i Shtetit.

3.5 Cilat janë format e raporteve që OJF-të mund t'i dërgojnë Komitetit CEDAW?

Çdo organizatë mund t'i dërgojë Komitetit CEDAW një raport hije (hije raport) ose alternative, përmes të cilave ajo informon Komitetin në lidhje me mënyrën se si shteti që monitorohet ka plotësuar detyrimet që përmban Konventa dhe Rekomandimet përkatëse.

Ndryshimi midis një raporti Hije dhe raportit Alternativ është se **Raporti Hije hartohet nga OJF-të duke patur akses dhe lexuar paraprakisht raportin e shtetit mbi zbatimin e Konventës**. Përmes raportit hije një OJF analizon në mënyrë kritike raportin që Shteti i ka paraqitur Komitetit dhe bën komente në lidhje me të. Kur një OJF e shkruan raportin e saj, kur raporti qeveritar nuk është përgatitur (p.sh sepse qeveria nuk e ka shkruar atë ose e shkruan me vonesë) ky raport quhet Raport Alternativ.

Burimi: International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), 2010, **Participation in the cedaw reporting process: process and guidelines for writing a shadow report**, fq. 11

Çdo OJF në hartimin e raporteve duhet të mbajë parasysh që t'i japë Komitetit të dhëna sa më të plota dhe të besueshme në lidhje me çështjet që po trajton.

18 International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), , Participation in the CEDAW reporting process: NGO interventions during and after the CEDAW session, April 2010

19 Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A TOOLKIT FOR REPORTING TO CEDAW ON TRAFFICKING IN WOMEN AND EXPLOITATION OF MIGRANT WOMEN WORKERS", fq 26.

Për shembull:

Nëse ju po përgatisni një raport hije/alternative në lidhje me Dhunën me bazë Gjinore merrni në konsideratë të përfshini në raportin tuaj:

- Të dhëna statistikore në lidhje me situatën e dhunës ndaj gruas në vend.
- Informacion në lidhje me situatën reale të grave të dhunuara në vend;
- Informacion në lidhje me impaktin dhe progresin e bërë nga shteti mbi zbatimin e Konventës dhe Rekomandimeve të Komitetit, në lidhje me Dhunën me bazë gjinore;
- Shkelje të të drejtave të grave dhe sidomos të dhëna në lidhje me evidentimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- Boshllëqe në ligj dhe politika shtetërore dhe rekomandime mbi plotësimin e tyre;
- Informacion rreth sfidave për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të grave viktime të dhunës me bazë gjinore.²⁰

3.6 Çfarë hapash duhet të ndërmarrin OJF-të për të përgatitur një raport Hijë/Alternativ?

Me qëllim që raporti i përgatitur nga organizatat të ndikojë sa më shumë në rekomandimet që Komiteti CEDAW do t'u shpërndajë shteteve sugjerohet që të merren parasysh hapat e mëposhtme:

1. Identifikoni prioritetet përmes një mbështetje të koordinuar.

Në përgatitjen tuaj për t'u përfshirë në procesin e raportimit tek Komiteti CEDAW, organizoni takime me sa më shumë organizata që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e të drejtave të grave, me qëllim që të identifikoni çështjet kryesore/urgjente që ndikojnë në mos gëzimin/ mos ushtrimin nga ana e grave të të drejtave në mënyrë të barabartë me meshkujt. Në çdo rast, pjesëmarrja në procesin e raportimeve si koalicion ose rrjet organizatash mund ta bëjë raportin tuaj më efektiv, duke qenë se ai është shprehje e zërit të një numri të madh grash. Kjo formë e raportimit sugjerohet sidomos, nëse OJF ka si qëllim të hartojë një raport hije/alternativ me karakter të përgjithshëm, për secilin Nen të Konventës. Në këtë rast OJF-të që operojnë në fusha të ndryshme mund të japin asistencën e tyre në përgatitjen e raportit sipas Neneve të Konventës.

Po kështu rekomandohet që OJF-të të bashkëpunojnë me njëra – tjetrën në rrjet për të paraqitur raporte sa më të plota, të cilat përfshijnë edhe çështje cross cutting si dhuna me bazë gjinore dhe gratë me aftësi të kufizuara, LGBTI, rome, etj.

Raportet e OJF-ve, sidomos ato të hartuara nga koalicionet OJF, shpesh kanë strukturën e Raportit të Shtetit, duke ofruar informacion në lidhje me secilin nen të Konventës. Një strukturim i tillë i shërben Komitetit si ndihmë gjatë procesit të rishikimit. Ato i japin mundësi Komitetit të krahasojë dhe të kryqëzojë informacionin e përfshirë në raportin e shtetit kundrejt informacionit alternative të ofruara nga OJF-të.

(Burimi: Coram Children's Legal Centre, UNICEF and UN Women, "Participant's Handbook, Module 7, fq 146, 2013)

20 International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), 2010, Participation in the CEDAW reporting process: process and guidelines for writing a shadow/alternative report, fq. 2

Modeli i krijimit të një rrjeti organizatash në hartimin e raporteve hije përpara Komitetit ka qenë evident në sesionet e mëparshme të rishikimit për shtetin shqiptar.

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri inicioi krijimin e Koalicionit për përgatitjen e Raporteve Alternative në Shqipëri i cili rezultoi me hartimin e një raporti hije mbi Situatën e të Drejtave të Grave në Shqipëri si produkt i punës së 13 organizatave në vitin 2006.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dërgoi në Shkurt 2016 një Raport Hijë në lidhje me të drejtat e grave në fushën e kujdesit shëndetësor me mbështetjen dhe bashkëpunimin e 21 organizatave të tjera të fushës.

Në qershor 2010 Aleanca Gjimore për Zhvillim në bashkëpunim me Rrjetin Shqiptar për Fuqizimin e Grave dhe Rrjetin kundër trafikimit dhe dhunës me bazë gjimore dërguan raportin hije mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri.

Raportet e OJF-ve, sidomos ato të hartuara nga koalicionet OJF, shpesh kanë strukturën e Raportit të Shtetit, duke ofruar informacion në lidhje me secilin nen të Konventës. Një strukturim i tillë i shërben Komitetit si ndihmë gjatë procesit të rishikimit. Ato i japin mundësi Komitetit të krahasojë dhe të kryqëzojë informacionin e përfshirë në raportin e shtetit kundrejt informacionit alternative të ofruara nga OJF-të.

(Burimi: Coram Children's Legal Centre, UNICEF and UN Women, "Participant's Handbook, Module 7, fq 146, 2013)

2. Mblidhni dhe analizoni informacionin/ të dhënat alternative

Sapo të keni rënë dakord në lidhje me çështjet shqetësuese, mblidhni të dhëna në lidhje me to dhe analizoni situatën konkrete të grave në fushën objekt raporti. Konventa CEDAW, VP në rishikimin e fundit dhe rekomandimet e përgjithshme të Komitetit duhet të përdoren nga ju si mjeti kryesor për vlerësimin e hapave dhe masave që ka marrë shteti, në mënyrë progresive. Të dhënat që do të mblidhni do t'iu shërbejnë për të hartuar rekomandimet, në lidhje me masat që duhet të merren për të eliminuar diskriminimin e grave në nivel kombëtar.

Për të hartuar raporte të suksesshme merrni në konsideratë sugjerimet e mëposhtme:

1. Përpiquni të kuptoni sa më mirë Konventën CEDAW. **Lexoni paraprakisht Vërejtjet Përmblyëse** që Komiteti CEDAW ka hartuar për Shtetin në monitorimin e fundit. Lexoni në lidhje me **parimet kryesore të Konventës CEDAW, Rekomandimet e Përgjithshme** të Komitetit CEDAW dhe **Protokollin Opsional** të saj.
2. Mblidhni dokumente që përmbajnë të dhëna në lidhje me statusin e grave në vend (ligje, vendime gjykatash, statistika). Përpiquni të mblidhni informacion në lidhje me suksesin ose dështimin e shtetit në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Konventa. **Nëse shteti ka bërë hapa pozitive mos i harroni pa përmendur ato!** (Në këtë mënyrë rritet besueshmëria e raportit tuaj). Nëse ka **dispozita ligjore** me natyrë diskriminuese i sillni ato në raport. Shihni gjithashtu edhe **vendimet gjyqësore!**
3. Mblidhni informacion në lidhje me **eficencën e organeve shtetërore** që kanë si detyrim promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të grave në veçanti. (Studioni p.sh. Efikasitetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në këtë drejtim).
4. Me interes do të ishte edhe puna e kryer nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili duhet të luajë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Konventës CEDAW;

Burimi (International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific),fq, 3 2010)

Për t'u marrë në konsideratë!

Nëse do të hartoni një raport hiqe mbi dhunën në bazë gjinore në sesionin e ardhshëm të CEDAW (2020) për Shqipërinë, merrni në Konsideratë të përfshini informacion në lidhje me masat që ka marrë shteti për të zbatuar vërejtjet përmbyllëse dhe rekomandimet e Komitetit pas raportimit të katërt periodik (2016).

Disa nga çështjet kyç të evidentuara nga Komiteti të cilat ju duhet t'i monitoroni:

- Përqindja e ulët e raportimit të dhunës me bazë gjininë;
- Aksesit i kufizuar i grave në shërbimet e ndihmës ligjore (fokusi tek gratë rurale);
- Ngritja e MR në të gjithë vendin dhe forcimi i MR ekzistuese; (në nivel lokal);
- Numër i pamjaftueshëm i strehëzave për gratë që janë viktime të dhunës në familje dhe kriteret shtrënguese për pranimin në to;
- Mungesa e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike në qendrat për rehabilitimin e grave të dhunuara;
- Dështim i shtetit në zbatimin e Urdhrave Mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershëm të Mbrojtjes²¹.

Rekomandimet që Komiteti i ka dhënë Shtetit në VP, ku ju sugjerohet të bazoheni lidhen me:

- Masa për të inkurajuar gratë të raportojnë dhunën me bazë gjinore duke ofruar ndihmë ligjore falas dhe ngritur linjat 24-orëshe të telefonit në të gjithë vendin;
- Forcimi i rolit dhe kapacitetit të autoriteteve kompetente për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës;
- Rritja e numrit të strehëzave, rritja e financimit të strehëzave të krijuara nga OJQ-të dhe krijimi i mekanizmave për kontraktimin dhe delegimin e shërbimeve në këto strehëza;
- Forcimi i zbatimit të Vendimeve gjyqësore, në veçanti të vendimeve të lëshimit të urdhrave Mbrojtës/urdhrave të Menjëhershëm Mbrojtës;
- Rritja e kapacitetit të personelit gjyqësor, përfshirë përmbaruesit.²²

Konsultohuni edhe me Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 35: “Dhuna me bazë gjinore kundër grave” (2017).

3. Përgatisni raportin Hiqe/Alternativ

Pasi të keni përcaktuar çështjet më problematike dhe të keni mbledhur informacionin e nevojshëm në lidhje me to është momenti që të hartoni raportin

21 Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2016) “Concluding observations on the fourth periodic report of Albania”, fq.6, në formatin online tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=En

22 Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2016) “Concluding observations on the fourth periodic report of Albania”, fq.6, në formatin online tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=En

tuaj për Komitetin CEDAW. Për këtë duhet të ndiqni rregullat procedurale të hartuara nga ky Komitet. Është e rëndësishme për OJF-të që të nënvizojnë në fillim të raportit çështjet strukturore që përbëjnë diskriminim ose që kanë dështuar për ta adresuar atë.

Organizimi i raportit:²³

1. Mënyra më e mirë për të organizuar raportin tuaj është sipas Neneve të Konventës, duke ndjekur linjën e raporteve qeveritare. Gjatë fazës së dialogut interaktiv, Komiteti ngre çështjet dhe pyet shtetin sipas Neneve të konventës. Për këtë arsye, organizimi i raportit në këtë formë i vjen në ndihmë Komitetit për të ngritur çështjet më me interes. Nëse ju po hartoni një raport hije, ai mund të organizohet si një qëndrim i juaji në lidhje me raportin e shtetit me të cilin ju jeni njohur më parë. Por, gjithashtu ju mund të hartoni një raport Hijë duke zgjedhur të jepni informacion **vetëm në lidhje me Nene të**

Në rastin e një raporti hije/alternative mbi dhunën me bazë gjinore nuk është e nevojshme të merrni në analizë të gjitha nenet e Konventës. Ju duhet të bazoheni tek detyrimet që vendos Rekomandimi 35 i Komitetit CEDAW (REk. 19 i rishikuar) si dhe tek Nenet e tjera të Konventës që mund të lidhen me dhunën ndaj grave (diskriminimi, Arsimi, Shëndeti, jeta familjare, etj.)

informacion **vetëm në lidhje me Nene të caktuara mbi të cilat ju keni ekspertizë.**

caktuara mbi të cilat ju keni ekspertizë.

Në Sesionin e 64 të Komitetit CEDAW, Qendra Për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNL) paraqiti Raportin e saj Hijë në lidhje me dy tematika të veçanta: Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor për fëmijët dhe të drejtat pronësore të grave në familje. Raporti tematik i paraqitur nga QNL në këtë rast ishte rezultat i veprimtarisë së përditshme të kësaj qendre duke i krijuar asaj kushte të përshtatshme për të identifikuar problemet më shqetësuese brenda fushës së ekspertizës si dhe mundësitë për zgjidhjen e tyre. Një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga ky raport u morën parasysh nga Komiteti dhe u bënë pjesë e Rekomandimeve të tij për shtetin shqiptar. Raportin mund ta gjeni tek: http://www.qag-al.org/ang/publication/shadow_report.pdf

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në raportin hije të vitit 2016 u fokusua në zbatimin e nenit 11 në industrinë e këpucëve dhe tekstile në Shqipëri. Raporti reflekton eksperiencën e qendrës në të drejtat e grave në tregun e punës. Pjesë e raportit me shume interes janë edhe historitë reale. Raportin mund ta gjeni tek: http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/INT_CEDAW_NGO_ALB_24256_E.pdf

Dokumentet mbështetëse mund të përfshijnë: Statistika, vendime gjyqësore, dëshmi të individëve, transmetime mediatike, dispozita ligjore, vendime qeveritare. Statistikat janë më të nevojshme nëse ndahen sipas moshës, gjinisë, gjendjes martesore etj.

2. Raporti duhet të shkruhet në mënyrë koncize, të qartë, të saktë dhe objektive. Informacioni që ju do të vendosni në raport duhet të jetë i besueshëm dhe të mbështetet në prova. Në çdo rast, në raport duhet të nënvizohen çështjet më problematike si dhe të përfshihen rekomandime në lidhje me përmirësimin e situatës së grave²⁴.

²³ Rregullat në lidhje me organizimin e raportit janë bazuar tek "Producing Shadow Reports to the CEDAW Committee: A Procedural Guide" nga International Women's Rights Action Watch të cilën mund ta konsultoni online tek <http://hrlibrary.umn.edu/iwraw/proceduralguide-08.html>

²⁴ *Kujdes! Midis çështjeve të trajtuara në rekomandimet përmbyllëse dhe raportimit tuaj duhet të ketë një lidhje logjike. Lidhja logjike duhet të ekzistojë edhe nëse raportoni në mënyrë alternative me informacionin e dhënë nga Shtetit. Pra, nëse çështja që ngrihet në to lidhet me nenin 1 të Konventës së CEDAW-t, ju do të raportoni në lidhje me të dhe jo në lidhje me nene të tjera të CEDAWt.*

3. Mbani parasysh të identifikoni çështjet më me prioritet në raport. Komiteti CEDAW nuk ka mundësi të fokusohet në të gjitha çështjet. Ju takon ju detyra, të përcaktoni problemet që mund të përfshihen në Listën e çështjeve të Komitetit.

Merrni në konsideratë për shembull: Pritja e ndërgjegjësimit qytetar mbi nevojën për raportim të dhunës me bazë gjinore; edukimi dhe trajnimi i aktorëve të nevojshëm (policia, nëpunësit shtetërorë, gjyqtarë, prokurorë, përmbaues) në lidhje me Konventën CEDAW, Rekomandimet e Përgjithshme, standardet Ndërkombëtare; forcimi i kapaciteteve mbrojtëse të viktimave të dhunës; statistika të ndara sipas gjinisë; buxheti gjinor dhe krijimi i një zëri të veçantë në buxhet për viktimat e dhunës me bazë gjinore në nivel vendor, etj.

Identifikoni se cilat janë vështirësitë më të mëdha në kuadër të garantimit të të drejtave të grave dhe bëni rekomandime specifike për të zgjidhur problemet. **Cilët aktorë duhet të përfshihen?** Kush duhet të trajnohet në lidhje me Konventën CEDAW dhe Rekomandimet e Përgjithshme të saj: Nëpunësit civilë në ministri, autoritetet lokale, policia, gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit e të drejtave të grave? A ka vështirësi në lidhje me burimet financiare të nevojshme për zbatimin e masave mbrojtëse?

Rast studimor:

Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë: Institucionet kompetente të shtetit duhet të bëjnë një përmbledhje të përgjithshme, duke përfshirë edhe gjendjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore lidhur me pagesën e detyrimeve ushqimore në favor të fëmijëve dhe të publikojnë të dhëna për këtë çështje. (Shkëputur nga raporti i QNL në sesionin 64 të rishikimit të CEDAW). Siç e shohim QNL në këtë rast identifikon aktorin kryesor përgjegjës për problemin e evidentuar prej saj në mungesën e të dhënave statistikore në lidhje me çështjen e trajtuar në raport.

Evidentimi i aktorëve përgjegjës për zgjidhjen e problemeve ka qenë një nga problematikat e evidentuara në raportet e dhëna nga OJF shqiptare në sesionet e rishikimit të Konventës. Mos lidhja e rekomandimeve me organin përgjegjës mund t'i bëjë jo efektive marrjen parasysh të rekomandimeve nga Komiteti apo edhe nga vetë qeveria shqiptare. Një pjesë e rekomandimeve janë të përgjithshme dhe nuk adresojnë zgjidhje efektive dhe institucionin përgjegjës për zgjidhjen e tyre.

4. Raporti duhet të përmbajë rekomandime konkrete që sugjerojnë veprime specifike. Për këtë lexoni paraprakisht Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit. Duhet të jeni sa më të qartë në hartimin e rekomandimeve.

Për shembull:

“Qeveria duhet të mbrojë gratë nga dhuna në familje” nuk është një rekomandim konkret. Do të ishte më e nevojshme të sugjeroni: Qeveria duhet: a) të mbledhë të dhëna të sakta në lidhje me rastet e dhunës ndaj grave në nivel kombëtar dhe lokal; të rrisë me 50% shpërndarjen e resurseve në strehëzat e grave; të trajnojë punonjësit e policisë për t'i ardhur në ndihmë viktimave të dhunës me bazë gjinore etj.

Burimi: IWRAW, 2008

5. Raporti sugjerohet të përmbajë në pjesën hyrëse të tij një përmbledhje ekzekutive në lidhje me përmbajtjen e raportit. Kjo përmbledhje e ndihmon

Mbani parasysh:

- I gjithë informacioni mbi një Nen mund të përmbledhet në një paragraf.
- Çdo paragraf me rëndësi mund të reduktohet në një fjali.
- Jo çdo fjali ose paragraf nevojitet të paraqitet në raportin ekzekutiv.

Burimi: IWRAW, 2008

komitetin për t'u njohur me çështjet kyç që kanë nevojë për ndërhyrje. Informacioni duhet të jetë i shkurtër, i saktë dhe të jetë shkëputur me kujdes nga raporti. Ai duhet të përfshijë çështjet kryesore të raportit hiqe, të dhënat që mbështesin çështjet kryesore si dhe rekomandimet për qeverinë në lidhje me adresimin e çështjeve kyç.

Integriteti i Raportit

Vlerësimi i besueshmërisë së informacionit të OJF-ve nga Komiteti CEDAW është një element themelor në procesin e monitorimit, i cili nuk duhet të mbajë rrezikun për t'u vënë në pikëpyetje besueshmëria e tij. OJF-të duhet të jenë shumë të kujdesshme të citojnë burimet e përdorura në raport dhe duhet të ndajnë qartë pozicionin dhe informacionin e ofruar prej tyre si OJF, nga raportet mediatike ose opinionet publike të referuara në raport. OJF-të janë të lira të paraqesin të dhëna zyrtare që nuk janë të paraqitura më parë nga qeveria në raportin e tyre. Kur OJF-të nuk kanë akses në informacion ose nuk kanë mundësi të komentojnë në lidhje me çështje të ndryshme, ato mund vetëm ta paraqesin atë në raport dhe të inkurajojnë Komitetin që të kërkojë më tepër informacion në lidhje me këto çështje në dialogun e tij me shtetin palë. Komiteti vlerëson transparencën e OJF-ve. Është më mjaft rëndësi që OJF-të të ngrenë pyetje të tyre gjatë raportit, por gjithashtu po aq e rëndësishme është që ato të japin edhe përgjigje. Përmes raportit të tyre, OJF-të duhet të japin rekomandime në lidhje me atë çka shtetet duhet të bëjnë në një perspektivë ligjore, politike ose ndërgjegjësimi.

Burimi: Coram Children's Legal Centre, UNICEF and UN Women, "Participant's Handbook, Module 7, fq 147, 2013)

6. Raporti nuk duhet të kalojë 3,300 fjalë (raporte individuale nga OJF-të) dhe 6,600 fjalë (raportet e Koalicioneve të OJF). Raporti, ose të paktën përmbledhja ekzekutive, duhet të shkruhen në anglisht dhe të tregojnë: emrin e plotë të OJF; Shtetin Palë me të cilin lidhet informacioni; nëse raporti mund të publikohet në faqen zyrtare të CEDAW. Raporti me shkrim dërgohet në format elektronik në adresën: CEDAW@ohchr.org.²⁵

3.7 Cila është struktura e raportit hiqe të OJF-ve?

Me qëllim që të ofrojë një pasqyrim të saktë të problemeve më kritike dhe të ofrojë adresimin e tyre përmes rekomandimeve specifike çdo raport hiqe duhet të përfshijë:

1. Faqja hyrëse që përfshin Titullin/ Autorët ose Emri i OJF/ve/ Emri i Shtetit Palë/ Tematika nëse është e përcaktuar/ Data e Raportit hiqe;
2. Përmbledhje Ekzekutive;
3. Tabela e Përmbajtjes;

25 International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAW Asia Pacific), 2010, **Participation in the CEDAW reporting process: process and guidelines for writing a shadow/alternative report.**

4. Hyrja: Jep informacion në lidhje me përgatitjen e raportit hije. Shpjego shkurt metodologjinë e përgatitjes së raportit. Në mënyrë të shkurtër përmbliidhni (1-2 paragrafë) çështjet më shqetësuese në lidhje me të drejtat e grave. *Nënvizo veçanërisht: çfarë parashikon Konventa për këto çështje, cilat janë dispozitat ligjore kombëtare që lidhen me çështjet, çfarë roli ka luajtur qeveria dhe çfarë masash ka marrë ose duhet të merret ajo për të adresuar problemet. Përfshi të dhëna statistikore, grafikë, dëshmi të viktimave të dhunës, etj.*
5. Pjesa kryesore e organizuar sipas Neneve të Konventës. *(Përfshin analizë të problemit sipas neneve; pyetjet kryesore që duhet të merren parasysh nga Komiteti për t'ia adresuar shtetit; rekomandimet e sugjeruara (mund të përfshijnë ndryshime të ligjit, politika, praktika në nivel qendror ose lokal.)*
6. Pjesa përmbyllëse.
7. Shtojca (mund të përfshijë tekste ligjesh, referenca etj).²⁶

3.8 Cili është roli i OJF në përgatitjen e Vërejtjeve Përmbyllëse dhe Rekomandimeve nga Komiteti CEDAW?

Pas fazës së dialogut interaktiv, Raportuesi për Shtetin formulon Vërejtjet Përmbyllëse dhe jep Rekomandimet për Shtetin objekt rishikimi. Këto nënvizojnë aspektet pozitive, çështjet shqetësuese si dhe Rekomandimet e Komitetit në lidhje me mënyrën se si duhet të adresohen nga shteti. Influencimi në Vërejtjet Përmbyllëse dhe rekomandimet është me shumë rëndësi. Komiteti do të monitorojë zbatimin e tyre nga ana e shtetit në sesionet e ardhshme. OJF-të mund t'i përdorin Vërejtjet Përmbyllëse dhe Rekomandimet për monitorimin progresiv, hartimin e raporteve të tyre dhe për të lobuar e advokuar për zbatimin e tyre në nivel kombëtar.

Është e rëndësishme të nënvizohet se që një çështje të përfshihet në Vërejtjet Përmbyllëse ajo duhet të jetë ngritur gjatë dialogut interaktiv. Për këtë arsye komunikimi i OJF-ve me Komitetin përpara dialogut interaktiv dhe në të gjitha format e shpjeguara më lart është thelbësor, për të siguruar që çështjet kyç janë ngritur përpara Komitetit.

Pas dialogut interaktiv, çdo OJF mund të përpiqet të takojë Raporterin e Shtetit dhe t'i japë atij një deklaratë mbi atë se çfarë do të dëshironte të shihte në Vërejtjet Përmbyllëse për shtetin Shqiptar. Por kjo deklaratë mund ti jepet edhe Sekretariatit të Komitetit, OHCHR, dhe IWRAW Asia Pacific, nëse kjo organizatë mbështet pjesëmarrjen tuaj në sesion.

26 "International Women's Rights Action Watch "Producing Shadow Reports to the CEDAW Committee: A Procedural Guide të cilën mund ta konsultoni online tek <http://hrlibrary.umn.edu/iwraw/proceduralguide-08.html>

3.9 Çfarë është procedura Follow-up dhe cili është roli i OJF-ve në këtë procedurë?

Procedura Follow-up ka si qëllim të asistojë Shtetin në lidhje me zbatimin e Konventës. Komiteti ka miratuar një procedurë follow-up të vërejtjeve të tij përmbyllëse dhe ka përcaktuar metodologjinë, sipas të cilës një shteti palë i kërkohet të paraqesë informacion brenda një ose dy viteve, mbi veprimet e ndërmarra për të zbatuar rekomandimet e përzgjedhura në kuadrin e procedurës follow up. Zakonisht përzgjidhen dy rekomandime.

Përzgjedhja e çështjeve bëhet në bazë të kriterit nëse çështjet e zgjedhura për veprim/masat afatshkurtra përbëjnë një pengesë për gëzimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të njeriut nga gratë dhe zbatimin e CEDAW në tërësi;

3.10 Cilat janë rregullat procedurale që OJF duhet të ndjekin në hartimin e raportit follow-up?

Gjatë procedurës follow-up OJF mund t'i paraqesin Komitetit CEDAW raporte alternative të cilat nuk duhet të jenë më shumë se 3500 fjalë. Afati i dërgimit të këtyre raporteve është një muaj pasi raporti follow-up i shtetit bëhet publik. Raportet e OJF-ve mund të dërgohen në format elektronik (në Word) tek CEDAW@ohchr.org

Për t'u konsideruar: Mbi procedurën follow-up për Shqipërinë (2018)

Komiteti i kërkon Palës Shtetërore që të sigurojë brenda dy vitesh, informacion me shkrim për hapat e ndërmarra në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të përfshira në paragrafët 13 (b) dhe (d) dhe 23 (a) dhe (d) të Vërejtjeve Përmbyllëse 2016 që konsistojnë në:

1. Të marrë masa për forcimin e autoritetit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore parësore ose dytësore duke përfshirë këtu edhe ngritjen e klinikave ligjore vendore të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike;
2. Të ndryshojë barrën e provës në rastet e pretenduara për diskriminim mbi bazë seksi ose me bazë gjinore
3. Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh;
4. Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve.

Shteti shqiptar duhet të paraqesë raportin në lidhje me 4 çështjet e theksuara më lart në Korrik 2018.

Kujdes!

Terminologjia që përdoret mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve follow up nga Shtetet është si vijon:

1. “Zbatuar” – në rast se shteti paraqet evidenca të plota të zbatimit të të gjitha rekomandimeve të dhëna nga Komiteti.

2. “Zbatuar në thelb”- në rast se Shteti paraqet të dhëna dhe fakte të veprimeve substanciale të marra në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, por që nuk i përgjigjet në mënyrë të plotë përmbushjes së rekomandimit.
3. “Zbatuar pjesërisht”- Në rast se Shteti ka ndërmarrë disa masa/veprime me qëllim zbatimin e rekomandimeve por ka nevojë për më shumë veprime për t’u përmbushur plotësisht detyrimet.
4. “Nuk është zbatuar”- Në rast se Shteti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit.
5. “Mungesë informacioni për të bërë vlerësim”.
6. “Informacioni ose masat e marra vijnë në kundërshtim me rekomandimin ose nuk e marrin parasysh atë”- në rast se Shteti nuk ndërmerr asnjë masë ose tregon se hedh poshtë rekomandimet e Komitetit.

Burimi: CEDAW Committee, Information on the follow-up procedure , 2017 tek http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_FGD_7103_E.pdf

3.11 Si mund të monitorojmë zbatimin e rekomandimeve follow up të Komitetit CEDAW për Shqipërinë dhe cilat janë disa nga treguesit²⁷ që mund t’i shërbejnë OJF-ve për të matur zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komitetit nga shteti shqiptar gjatë fazës follow-up?

REKOMANDIM Nr.13 (b): Të marrë masa për forcimin e autoritetit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore parësore ose dytësore duke përfshirë këtu edhe ngritjen e klinikave ligjore vendore të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike;

Në lidhje me marrjen e masave për ofrimin e ndihmës juridike falas, disa nga treguesit që mund të përdoren janë:

- Niveli i përfshirjes në ligjet/aktet nënligjore/strategjitë dhe politikat përkatëse të masave /dispozitave që parashikojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ndryshimet ligjore me ligjin nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Burimi i informacionit: Analizë ligjore;

- Numri i rasteve të viktimave të dhunës me bazë gjinore që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga KSHNJ gjatë dy viteve të fundit, të ndara sipas formës së dhunës gjinore, qytet/fshat, grupeve të marginalizuara nga vijnë rastet, llojit të ndihmës/ moshës së viktimës/ origjinës etnike.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD, KSHNJ; analiza vjetore të MD,etj;

- Numri i klinikave ligjore (të ngritura nga shteti dhe organizatat) që ofrojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, të ndara

²⁷ Treguesit dhe burimet e listuara nuk janë shteruese. Ato do të zhvillohen më tej në konsultim me OJF-të si dhe në trajnimin që QNL do të organizojë për monitorimin e standardeve që burojnë nga CEDAW, GREVIO dhe UPR;

sipas: a) qytetit, b) llojit të ndihmës juridike të ofruar, c) llojin e ofruesit (avokatët, sektori publik, joqeveritar, Organizatat) të ngritura gjatë dy viteve të fundit.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD; analiza vjetore të dy viteve të fundit të MD; web i UNDP; web i Fondacionit SOROS për informacion mbi klinikat ligjore në universitete; web i OJF-ve²⁸, media sociale e organizatave të tjera që kanë ngritur klinika ligjore gjatë dy viteve të fundit;

- Të dhëna në lidhje me kapacitetet njerëzore, trajnimet e stafit dhe buxhetin e klinikave ligjore të ngritura;
- Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës gjinore, që kanë përfituar ndihmë juridike parësore dhe dytësore gjatë dy viteve të fundit nga KSHNJ.
- Të dhëna në lidhje me krijimin e një formulari të standartizuar në lidhje me ndihmën ligjore, krijimin e një databaze në lidhje me statusin e kërkesës së çdo subjekti të interesuar.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD, KSHNJ; analiza vjetore të MD;

- Përqindja e organizatave joqeveritare të grave që marrin fonde shtetërore për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, në krahasim me numrin e përgjithshëm të OJF që ofrojnë këtë ndihmë çdo vit.

Burimi i informacionit: raportet e OJF-ve që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, në nivel kombëtar;

REKOMANDIM Nr.23 (a): Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh;

Në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e linjave telefonike të këshillimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore, disa nga treguesit që mund të përdoren janë:

- Niveli i përputhjes së politikave dhe standardeve të ofruesve të këtij shërbimi të specializuar për viktimat e dhunës me standardet e përcaktuara në Rekomandimin e Pwrgjithshëm të Komitetit Cedaw Nr.35 dhe 19.

Burimi i informacionit: Analizë e standardeve; raporte monitoruese të aktivitetit të linjave; intervistë me punonjës të linjës kombëtare të këshillimit dhe përfituese, raporte të punës së MR në bashki të ndryshme, etj.

- Numri i linjave telefonike 24-orëshe në nivel kombëtar dhe lokal, që ofrojnë këshillim për viktimat, në mënyrë konfidenciale, në lidhje me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore;

28 Me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD dhe fonde të Qeverisë së Turqisë janë ngritur klinika ligjore në Durrës, Tiranë, Fier dhe Lezhë;

- Numri i përfituesve të këtij shërbimi, çdo vit.
- Numri i raportimit prane mekanizmave te referimit si dhe numri i rasteve te regjistruara ne sistemin REVALB.
- Përqindja e thirrjeve drejtuar linjave telefonike, të ndara sipas formës së dhunës;
- Burimet e financimit të linjës kombëtare të këshillimit dhe shuma vjetore për këtë program;
- Përqindja e fondeve nga buxheti vjetor dedikuar për funksionimin e linjës kombëtare të këshillimit dhe/ose linjave telefonike 24-orëshe (24/7) që ofrojnë këshilla falas për telefonuesit, në lidhje me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në krahasim me buxhetin total për shërbimet në këtë fushë.(të dhënat mbi buxhetin e linjave telefonike të këshillimit të ndara në nivel kombëtar dhe lokal)
- Të dhëna në lidhje me trajnimin e stafit të linjës kombëtare të këshillimit dhe/ose linjave telefonike dhe specializimin e tyre për të këshilluar rastet e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe këshillimin edhe të dëshmitarëve të dhunës në përputhje me moshën e tyre;

Burimi i informacionit: Raporte të aktivitetit të linjave telefonike; raporte vjetore të MSHMS dhe bashkive të ndryshme ku është ngritur MR dhe funksionojnë linjat telefonike falas; Intervista me stafin e linjave telefonike; etj.

- Të dhëna në lidhje me fushatat ndërgjegjësuese që kanë si synim të nxisin numrin e raportimeve të rasteve të dhunës me bazë gjinore si edhe të dhëna mbi buxhetimin e fushatave ndërgjegjësuese.

Burim informacioni: Studime të Observatorit mbi identifikimin e fushatave ndërgjegjësuese që kanë pasur impakt pozitiv te publiku per ndërgjegjesim dhe raportim te rasteve te dhunes

- Të dhëna në lidhje me trajnimin e medias për konfidencialitetin e të dhënave.

Në lidhje me raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ju mund të kërkonti informacion në lidhje me:

- Përqindja e raportimeve të dhunës me bazë gjinore të bëra nga dëshmitarët ose viktimat në krahasim me numrin total të të gjitha formave të dhunës së raportuar çdo vit.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar DPPSH dhe/ose drejtorive të policisë në qarqe, komisariateve të policisë; Kërkesë për informacion drejtuar bashkive të ndryshme ku janë ngritur MR, koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje;

- Numri i fushatave dhe/ose iniciativave në nivel lokal, që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e raportimit të dhunës me bazë gjinore të kryera çdo vit nga a) MSHMS, b) Ministrinë e linjës c) organizatat joqeveritare dhe d) bashkitë.

Burimi i informacionit: raporte të MSHMS, raporte të OJF-ve, raporte të bashkive, kërkesa për informacion drejtuar bashkive; intervista medrejtues të OJF-ve, etj.

- Numri i shërbimeve mbështetëse për viktimat dhe dëshmitarët e dhunës me bazë gjinore, të ngritura gjatë vitit të fundit a) në nivel qendror dhe b) në nivel vendor; c) në nivel qarku;

Burimi i informacionit: raporte të SHSSH dhe DRSHSSH, raporte të MSHMS, raporte të MR; raporte të bashkive; raporte monitorimi të MR; etj.

- Numri i raportimeve të bëra në a) polici; b) pranë koordinatoreve vendore kundër dhunës në familje në nivel vendor dhe c) institucione të tjera përgjegjëse, anëtare të MR, në vështrim krahasues;
- Niveli i përputhshmërisë së konfidencialitetit të bazës së të dhënave të viktimave dhe dëshmitarëve të dhunës në raport me standardet/ rregullat e pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me raportimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;

Burimi i informacionit: Numri i ankesave;

- Numri i rasteve/kërkesave për UM dhe UMM të iniciuara kryesisht nga prokuroria/policia pas dëshmisë së dhënë nga viktimat e dhunës në familje;

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar DPPSH dhe/ ose drejtorive të policisë në qarqe, komisariateve të policisë; Kërkesë për informacion drejtuar bashkive të ndryshme ku janë ngritur MR, koordinatoreve vendorë kundër dhunës në familje;

REKOMANDIM Nr.13 (d): Të ndryshojë barrën e provës në rastet e pretenduara për diskriminim mbi bazë seksi ose me bazë gjinore në favor të ankuesve.

Në lidhje me ndryshimin e barrës së provës në rastet e pretenduara për diskriminim me bazë seksi mund të përdorni si tregues:

- Niveli i përputhjes së dispozitave ligjore që përcaktojnë barrën e provës në rastet e diskriminimit gjinor me parashikimet e Konventës CEDAW; Analizë ligjore e ndryshimeve në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”/ Kodi i Punës në lidhje me përmbysjen e barrës së provës;

Burimi i informacionit: desk study;

- Përqindja e vendimeve gjyqësore në të cilat provat që lidhen me historinë seksuale dhe sjelljen e viktimës janë pranuar si të rëndësishme dhe të nevojshme nga gjykata, në krahasim me numrin e përgjithshëm të vendimeve gjyqësore mbi dhunën me bazë gjinore;
- Të dhëna në lidhje me vendimet gjyqësore të rrëzuara nga gjykata për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme nga viktimat e diskriminimit;

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore; raporte të OJF-ve që punojnë në këtë fushë; web e OJF-ve që punojnë në këtë fushë; vendime gjyqësore, intervista me avokate që punojnë për OJF-të, gjyqtarë, staf të KMD, etj.;

- Të dhëna në lidhje me numrin e ankesave/informacioneve të paraqitura pranë KMD, me pretendimin për diskriminim për shkak të seksit;
- Të dhëna në lidhje me vendimet në të cilat KMD ka gjetur diskriminim dhe ka zbatuar barrën e përmbysur të provës, për këto çështje;
- Të dhëna në lidhje me vendimet në të cilat KMD ka vendosur pushim ose nuk ka gjetur diskriminim për këto çështje;

Burimi i informacionit: Raporte vjetore të paraqitura në Kuvend nga KMD; web i KMD, vendime të KMD; Rezoluta të Kuvendit për raportet e KMD; etj.

REKOMANDIM Nr.23 (d): Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor, si përmbauesit gjyqësorë.

Në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore, dhe sidomos për UM dhe UMM:

- Numri i nëpunësve publikë (të ngarkuar me detyrimin ligjor për të zbatuar Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes) të trajnuar profesionalisht në lidhje me çështje të dhunës me bazë gjinore dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e UMM/UM nw periudhwn 2016-2018;
- Numri i trajnimeve të zhvilluara gjatë dy viteve të fundit me këtë objekt për a)punonjësit e zyrave të përmbaimit; b)punonjësit e policisë; c) punonjës të Zyrave të Shërbimeve Sociale pranë bashkisë; d)ekipet teknike të MR; e)OJF;

Burimi i informacionit: Analiza vjetore të institucioneve si MD, DPPSH, bashkive, OJF-ve; etj.

- Përqindja e rasteve të dhunës së raportuar ku viktimave, të pajisura me UMM/UM nuk iu është siguruar mbrojtja e shpejtë dhe adekuate nga autoritetet përkatëse (policia/përmbauesit/ punonjësit social);
- Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje që kanë humbur jetën, ndonëse kanë qenë të pajisura me UMM/UM ose ndaj te cilave është vazhduar te ushtrohet dhune pavarësisht denoncimeve të bëra gjatë kohës që kanë qënë të pajisura me UM.

Burimi i informacionit: Raporte të DPPSH, media, OJF që mbështesin viktimat e dhunës me bazë gjinore;

- Përqindja e vendimeve gjyqësorë te UMM/UM, të zbatuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore;

Burimi i informacionit: të dhëna nga DPPSH, MD, të dhëna nga zyrat e përmbartimit, zyrat e shërbimeve sociale pranë bashkive komisariatet e policive, etj.;

- Mjete ligjore për mbrojtjen urgjente për viktimat e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore; **Burimi i informacionit:** analizë ligjore;
- Numri i dhunueseve të ndëshkuar për shkelje të urdhrave mbrojtjes, në krahasim me numrin e përgjithshëm të urdhrave të tilla;
- Numri i procedimeve penale efektive dhe të shpejta në rastet e shkeljes së UMM/UM, çdo vit.

Burimi i informacionit: Vjetari statistikor i MD, të dhëna nga DPPSH;

- Numri i masave disiplinore të marra nga SHKB dhe KLD për profesionistët e sistemit që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në zbatim të UMM/UM;

Burimi i informacionit: Ankesa të paraqitura për mospërmbushje të detyrimeve ligjore nga punonjësit përgjegjës; raporte të OJF-ve që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës në familje, kërkesa për informacion drejtuar SHKB, kërkesa për informacion drejtuar KLD; përgjigje zyrtare nga këto institucione, etj.

A përfundon roli i OJF-ve pas publikimit të Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë?

Jo. OJF-të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e shtetit, në mënyrë që ai të veprojë sipas rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAW në fund të procesit të rishikimit. Në këtë fazë, OJF-të mund të ndërhyjnë në mënyra të ndryshme:

- Mund të monitorojnë zbatimin e rekomandimeve që gjenden në Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit;
- Hartojnë Raporte Follow-up dhe ia dërgojnë Komitetit, si në rrugë formale ashtu edhe informale. Kjo ndihmon Komitetin të vlerësojë progresin që Shteti shqiptar ka bërë nga një sesion në një tjetër.
- Mbështesin publikimin dhe shpërndarjen e Vërejtjeve Përmbyllëse dhe dokumenteve të tjera të hartuara nga Komiteti.
- Llobojnë dhe advokojnë me pushtetin qendror dhe vendor, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit, përmes takimeve individuale, tryezave teknike, konferencave apo formave të tjera, duke ftuar edhe përfaqësues të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut si institucioni i Avokatit të Popullit.
- Ofrojnë ndihmë në zbatimin e masave apo veprimeve që adresojnë rekomandimet që gjenden tek Vërejtjet Përmbyllëse.
- Ofrojnë inpute për raportet e shtetit si në raportimin periodik ashtu edhe në raportimin follow up.

PJESA E DYTË

2. PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË PROCESIN UPR

2.1 Hyrje

Rishikimi Periodik Universal u krijua në 2006 si një proces i Këshillit të të drejtave të Njeriut. Procesi rishikon situatën e të drejtave të njeriut në secilin prej 193 shteteve të Kombeve të Bashkuara çdo 4.5 vjet²⁹. Angazhimi i OJF dhe shoqërisë civile është me shumë rëndësi gjatë këtij procesi. Përmes angazhimit në UPR çdo OJF ka mundësi:

- Të ngrejë shqetësimet e veta në lidhje me çështje specifike të të drejtave të njeriut
- T'i drejtojë pyetje specifike qeverisë në lidhje me garantimin e të drejtave të njeriut
- Të unifikojë veprimtarinë e saj me orgnizatat e tjera që ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtën fushë me qëllim hartimin e rekomandimeve specifike për të ndryshuar gjendjen në vendin e tyre
- Të influencojë në nxjerrin e rekomandimeve nga Grupi i Punës në fund të procesit të rishikimit për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin e tyre.
- Të ndihmojë në përmbushjen e rekomandimeve nga ana e Shtetit.

OJF mirëprehen të jenë aktive gjatë procesit të rishikimit universal me qëllim përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe grupit të të drejtave që ato mbrojnë në veçanti. Procesi UPR i jep mundësi OJF të bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim që kontributi i tyre të influencojë rezultatet dhe rekomandimet që dalin në fund të procesit të rishikimit.


Kjo pjesë e Manualit paraqet një prezantim të shkurtër të procesit të rishikimit dhe përmban rekomandime dhe sugjerime për OJF me qëllim që përfshirja e tyre në procesin e rishikimit të jetë sa më e suksesshme.

2.2 Çfarë është UPR?

Rishikimi Periudik Universal (UPR) është një mekanizëm i ri për të drejtat e njeriut i Këshillit të të Drejtave të Njeriut (KDN) i krijuar në 15 Mars 2006 nga rezoluta 60/251 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Përmes këtij mekanizmi rishikohet plotësimi i detyrimeve të 193 shteteve anëtare të OKB në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe progresi, sfidat dhe nevojat për përmirësim në mënyrë që të garantohen efektivisht korpusi i të drejtave të njeriut i njohur nga instrumentat ndërkombëtare. Shtetet monitorohen dhe kalojnë në procesin e rishikimit çdo 4.5 vjet. UPR është

²⁹ Human Rights Project "A practical guide to the United Nations' Universal Periodic Review", fq 5, 2010

disenjuar për t'u aplikuar universalisht dhe në uniformitet për të gjitha shtetet. UPR është një mekanizëm inovativ dhe bashkëpunues që bazohet në modelin e dialogimit midis shtetit që është në rishikim dhe çdo shteti tjetër të OKB. Procesi zgjat 3 ½ orë. Gjatë fazës së dialogut interaktiv, shteti paraqit raportin e tij, i përgjigjet pyetjeve dhe merr rekomandime nga çdo shtet tjetër.(90 minuta). Procesi lehtësohet nga një grup prej tre raportuesish të quajtur Trojka të cilët përgatisin listën e çështjeve dhe pyetjet për shtetin në proces rishikimi bazuar në informacionin e dërguar nga shtetet e tjera. Pyetjet i jepen Shtetit dhe qarkullohen në Grupin e Punës të paktën 10 ditë përpara rishikimit. Pas dialogut, Trojka përgatit një raport të Grupit të Punës me Shtetin nën rishikim dhe me asistencën e Sekretariatit Këshillit, i cili përmban një përmbledhje të plotë të procesit. Rishikimi përfundon me një dokument i cili përmban të gjitha rekomandimet që ia janë bërë shtetit në proces rishikimi i cili miratohet zyrtarisht në sesionin pasues të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.



Burimi Human Rights Project "A practical guide to the United Nations' Universal Periodic Review", 2010

2.3 Kush merr pjesë në procesin e rishikimit? A mund të marr pjesë unë si OJF në Grupin e Punës?

Rishikimi kryhet nga të gjitha Shtetet Anëtare të OKB (përfshirë 47 shtetet anëtare të Këshillit të të drejtave të njeriut dhe shtetet me status vëzhgues) me pjesëmarrjen e Shtetit që i nënshtrohet këtij procesi. Grupi i Punës përbëhet nga 47 shtetet anëtare të KDN dhe kryesohet nga presidenti i Këshillit të të Drejtave të njeriut. Procesi i Rishikimit lehtësohet nga tre raportuesit (Trojka)

të zgjedhur nga 47 shtetet Anëtare të Këshillit. OJF mund të marrin pjesë në sesionet e Grupit të Punës, por nuk mund të ndërhyjnë.

2.4 Cilat janë instrumentat objekt rishikimi?

OJF duhet që paraprakisht të njihet me listën e dokumentave që janë objekt i rishikimit gjatë UPR. Kështu, gjatë procesit UPR, çdo shtet rishikohen në lidhje me zbatueshmërinë e instrumentave ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që konsistojnë në:

1. Karta e Kombeve të Bashkuara
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
3. Instrumentat e të drejtave të njeriut, traktate, konventa të ratifikuara nga Shteti që Rishikohet.
4. Zotimet që ka marrë Shteti përsipër, përfshirë ato që ka marrë kur paraqet kandidaturën për zgjedhjen në Këshilli e të Drejtave të Njeriut
5. E drejta humanitare e aplikueshme.³⁰

2.5 Cilat janë dokumentat bazë objekt i procesit UPR?

Paraqitja e raporteve të shkruara është një nga fazat paraprake të procesit të rishikimit periodik universal. Për çdo shtet që është objekt i rishikimit dokumentat të nevojshme për këtë proces janë:

1. **Informacioni i përgatitur nga Shteti** në procesin e Rishikimit: Shteti në këtë rast është i detyruar të hartojë një raport të shkruar, maksimumi 20 faqe, përmes të cilit jep informacion në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut si dhe informacion në lidhje me arritjet, praktikat më të mira të ndjekura prej tij apo sfidat me të cilat ai përballet në plotësimin e detyrimeve. Shtetet inkurajohen të bashkëpunojnë ngushtë me shoqërinë civile në këtë fazë për të hartuar raportin e tyre.
2. **Informacion i mekanizmave të Kombeve të Bashkuara hartuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut:** 10 faqe raport që përmban informacion nga organet e traktateve, eksoertëve ndërkombëtarë ose raporterëve special, agjencive të OKB dhe dokumenta të tjerë me rëndësi të Kombeve të Bashkuara.
3. **Përmbledhje e raporteve të OJF/** grupeve të interesit nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut: Informacion që përfshin një përmbledhje prej 10 faqesh të informacionit të besueshëm të përgatitur më parë nga OJF dhe grupet e tjera të interesit në nivel kombëtar.³¹

30 Dokumentat objekt rishikimi janë parashikuar nga Rezoluta 5/1 e Këshillit të të Drejtave të Njeriut miratuar në 18 qershor 2008, në paragrafin 1 të Aneksit të saj, të cilën mund ta konsultoni tek <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/BasicFacts.aspx>

31 Shih paragrafin 5 të Aneksit të Rezolutës 5/1 të Këshillit, 2008.

Për sa më sipër OJF përmes hartimit të raporteve alternative në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në Shtetin e tyre bëhen pjesë e procesit të rishikimit.

□ Duke qënë se UPR është një proces rishikimi i shteteve ndaj shteteve me njërin tjetrin, a mund të përfshihem unë si OJF në këtë proces?

Roli i OJF në procesin e rishikimit të shteteve është mjaft i rëndësishëm. Edhe pse procesi në vetvete përmban një hapësirë të kufizuar për përfshirjen e OJF, ndikimi i tyre përpara dhe pas procesit të rishikimit mund të përmirësojë funksionimin dhe efektivitetin e gjithë procesit përmes ekspertizës së tyre dhe njohurive në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në fushat që ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre.³² **Ju mund të bëheni pjesë aktive e UPR duke:**

- Marrë pjesë në konsultime me qeverinë
- Dërguar një raport si palë e interesuar në proces
- Lobuar me shtetet e tjera palë të OKB të cilat marrin pjesë në proces
- Ndjekur sesionet e Grupit të Punës gjatë UPR
- Ndjekur dhe marrë pjesë në sesionet e Këshillit të të Drejtave të Njeriut
- U bërë pjesë e procesit follow-up dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve nga ana e Shtetit³³

2.6 Pse duhet OJF të konsultohet me qeverinë në fazën para përgatitore?

Konsultimi i qeverisë me palët e interesuara, OJF vjen si një sugjerim i Këshillit të të Drejtave të Njeriut sipas të cilit përpara se të përgatisin raportin kombëtar shtetet duhet të konsultohen me OJF që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye ju duhet të informoheni në lidhje me kohën se kur janë të planifikuara tryezat teknike të konsultimit të qeverisë me grupet e interesit në mënyrë që të bëheni pjesë e procesit. Konsultimi paraprak është me interes pasi çështjet që ju i mendoni si më të rëndësishme, përmes këtij procesi, mund të bëhen pjesë e raportit kombëtar të shtetit i cili më pas do të rishikohet nga shtetet e tjera. Gjatë konsultimit me qeverinë ju duhet paraprakisht të përgatisni listën e çështjeve shqetësuese që t'ia adresoni qeverisë. Çështjet që ju ngrini duhet të përfshijnë periudhën 4 vjeçare për të cilën shtetet do të rishikohen.

Bëhuni pjesë e tryezave teknike të konsultimeve të qeverisë me grupet e interesit në mënyrë që shqetësimet tuaja të adresohen në raportin kombëtar të dorëzuar nga Shteti. Hartoni paraprakisht një listë çështjesh që mendoni se kanë nevojë për t'u përfshirë në raport në mënyrë që të bëhen pjesë e dialogut interaktiv të shtetit tuaj me shtetet e tjera.

32 Pusey.L "A guide to the Universal Periodic Review Process for NGO's and NHRIs", IRWAW.

33 Shih gjithashtu Information And Guidelines For Relevant Stakeholders On The Universal Periodic Review Mechanism tek <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Documents/TechnicalGuideEN.pdf>

Për t'u kujtuar! Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile ka qënë një nga rekomandimet e dala nga UPR në Sesionin e II, 2014 nga Angola kundrejt shtetit shqiptar!

2.7 A mund unë si OJF të dërgoj informacion në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut direkt tek Këshilli i OKB?

Njëlloj si në raportimet përpara Komitetit CEDAW apo GREVIO, çdo OJF mund të dërgojë një raport në lidhje me çështje specifike të të drejtave të njeriut dhe përmbushjen e detyrimeve të shtetit në lidhje me to. Sa më të organizuara dhe specifike të jenë raportet tuaja aq më shumë mundësi keni që çështjet që ju ngrini të bëhen pjesë e raportit përmbledhës të të gjitha OJF nga Këshilli i Drejtave të Njeriut.

2.8 Çfarë duhet të përmbajë raporti i dërguar nga OJF që të pranohet nga Këshilli?

Në mënyrë që raporti i dërguar prej jush të pranohet nga Këshilli, ju duhet të respektoni kriteret dhe rregullat procedurale për hartimin e tij.

- 1. Përmbledhja ekzekutive:** Raporti duhet të përfshijë një përmbledhje ekzekutive e cila duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur atë çka ju doni të adresohet në procesin UPR. Kjo përmbledhje duhet të përfshijë çështjet më të rëndësishme që përmban raporti. Na shumicën e rasteve çështjet e vendosura në përmbledhjen ekzekutive janë ato që Këshilli përfshin në raportin përmbledhës të të gjitha OJF dhe palëve të tjera të interesuara.
- 2. Identifikimi i organizatës:** Raporti duhet të përmbajë një paragraf të shkurtër në lidhje me informacionin mbi OJF tuaj, emrin e organizatës, të dhënat si dhe fushat kryesore ku organizata ushtron veprimtarinë e saj.
- 3. Gjuha e raportit:** Edhe pse raportet mund të shkruhen në secilën prej gjuhëve zyrtare të OKB, më të preferuara janë raportet e shkruara në **Anglisht, Frëngjisht ose Spanjisht**.
- 4. Numri i fjalëve:** Raportet duhet të jenë të shkurtra dhe të mos përmbajnë më shumë se **2815 fjalë** (afërsisht 5 faqe) në rastin e raporteve individuale **dhe 5630** (afërsisht 10 faqe) në rast të raporteve të shkruara nga koalicionet OJF. Anekset dhe materialet shtesë që mbështesin argumentat mund të bashkangjiten në formën e anekseve/shtojca për referencë. Nuk ka kufizim faqesh në lidhje me to, megjithatë ato nuk mund të përmbajnë piktura, harta, raporte vjetore të organizatës apo organizatave të tjera. Informacioni në footnote/endnote nuk llogaritet në numrin e fjaleve të raportit.
- 5. Formati:** Çdo raport duhet të shkruhet në format Word, Times New Roman, numer shkrimi 12. Për lehtësi referimi paragrafët dhe faqet duhet të numërtohen.

6. Afati: UPR organizohet në periudha periodike çdo 4.5 vjet. Çdo raport i dërguar duhet të mbulojë pikërisht këtë periudhe dhe nuk mund të përmbajë informacione në lidhje me periudhat më të hershme. OJF duhet të kontrollojnë rregullisht faqen zyrtare të OHCHR UPR webpage për të parë afatet kur ato duhet të dërgojnë raportet. Shihni për më tepër <https://www.upr-info.org/en/review/Albania> për afatet për Shqipërinë.³⁴

Sesioni vijues i Rishikimit për Shqipërinë është në MAJ 2019. OJF duhet të dërgojnë raportin e tyre të shkruar në 20.09.2018!

7. Mënyra e dëgimit: Raportet e OJF duhet të dërgohen **në rrugë elektronike** përmes “On-line UPR Submissions Registration System” në adresën <https://uprdoc.ohchr.org> jo më vonë se data e përcaktuar, ora 11.59 p.m.

Kujdes!

Raportet nuk merren në konsideratë nga Këshilli:

- Nëse kalojnë numrin limit të fjalëve;
- Nëse shkruhen në një gjuhë jo zyrtare të OKB;
- Nëse dërgohen në tejkalim të afatit të përcaktuar;
- Nëse përmbajnë gjuhë abusive.

Burimi: Human Rights Project “A practical guide to the United Nations’ Universal Periodic Review”, 2010

2.9 Çfarë duhet të kem parasysh për të hartuar një raport të suksesshëm në fushën e dhunës me bazë gjinore?

Në mënyrë që të hartoni një raport të suksesshëm, që të përfshihet në raportin përmbledhës të hartuar nga Këshilli sugjerojmë që të:

- 1.** Konsultoni paraprakisht detyrimet që ka Shqipëria në kuadër të dhunës me bazë gjinore. Përpara se të draftoni raportin është e rëndësishme të merrni në konsideratë instrumentat ligjore ndërkombëtare që ka ratifikuar shteti shqiptar në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe dhunës me bazë gjinore. **(Përshembull: detyrimet që rrjedhin nga ratifikimi i Konventës CEDAW, Konventës së Stambollit).**
- 2. Zgjeroni sferën e shtrirjes së raportit edhe në nivel lokal.** Sugjerojmë që të nënvizoni në raport edhe çështjet shqetësuese të evidentuara në nivel lokal, në mënyrë që të theksoni shtrirjen më të gjerë të problemit. **(Mund të përfshini situatën e mbrojtjes së të drejtave të grave të dhunuara në zonat rurale, linjat telefonike 24 orëshe, trajnimin e nëpunësve të administratës lokale, ndërgjegjësimin dhe edukimin në nivel lokal mbi legjislacionin në fuqi dhe planet e veprimit në fushën e dhunës me bazë gjinore etj.)**

34 Shih Universal Periodic Review (Third Cycle): Information and guidelines for relevant stakeholders’ written submissions. Dokumentin e plotë mund ta gjeni tek <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/TechnicalGuide.aspx>.

3. **Nënvizoni rekomandimet:**

Raporti që ju si organizatë do të dërgoni në Këshill duhet të fokusohet në ofrimin e zgjidhjeve dhe jo tek problemet. Raportet e OJF që përmbledhin shkurtimisht problematikën dhe më pas fokusohen në ofrimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e situatës janë më efektive dhe të suksesshme. Kjo nga ana tjetër lehtëson edhe rolin e shteteve të tjera për të sugjeruar çështje specifike dhe rekomandime për shtetin. Kur adresoni problemin kini parasysh që ta mbështesni me shembuj reale dhe konkretë në mënyrë që të ndihmoni lehtësimin e diskutimeve gjatë rishikimit. Gjithashtu mbani parasysh që rekomandimet që do të jeni apo zgjidhjet që do të ofroni duhet të jenë të mundshme për t'u përmbushur brenda afatit prej 4 vjetësh nga shteti.

Metoda S.M.A.R.T e aplikuar në UPR ndihmon në shkrimin e rekomandimeve precize dhe të orientuara në veprime dhe zgjidhje efektive. Në baze të kësaj metode rekomandimet duhet të jenë: **Specifike** (kërkon një veprim konkret për një shkelje konkrete) , **të Matshme** (a mund të monitorohet dhe të vlerësohet zbatimi i rekomandimit?), **të Arritshme** (a ka kapacitetet shteti për të zbatuar rekomandimin? Bazohet në kapacitete materiale jo vullnet politik), **Relevante** (A është rekomandimi relevant me situatën e vendit dhe a con në përmirësim të saj?) dhe **Të lidhura me kohën** (rekomandime të mundshme për t'u përmbushur deri në sesionin e ardhshëm). Hartimi i rekomandimeve efektive është produkti më i rëndësishëm i procesit të rishikimit. Rekomandimet mund të tregojnë që zbatimi ose dështimi mund të maten dhe të raportohen në ciklin e ardhshëm të rishikimit. Metoda S.M.A.R.T nënkupton që rekomandimet janë: të lehta për t'u zbatuar (kjo pasi rekomandimet e paqarta janë më të vështira për t'u interpretuar dhe njëkohësisht për t'u zbatuar) dhe të lehta për t'u monitoruar. Një rekomandim preciz duhet të sqarohet në mënyrë të qartë se çfarë veprimi duhet të ndërmerret shteti për ta përmirësuar gjendjen. (Amendime për nene të caktuara të ligjit “për Mbrojtjen nga Diskriminimi”/ ratifikim konventash/ trajnime për aktorë të caktuar përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore/ritje e strehëzave për viktimat e dhunës me bazë gjinore/ përfshirja e dhunës me bazë gjinore si zë në buxhet etj)

Burimi: UPR info, The Civil Society Compendium, A comprehensive guide for Civil Society Organisations engaging in the Universal Periodic Review, 2017, fq 54

4. **Citoni instrumentat ndërkombëtare:** Përpiquni që gjatë raportit t'i referoheni instrumentave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti në rast të shkeljeve nga ky i fundit të detyrimeve të parashikuara në to. Një metodë e tillë lehtëson procesin e diskutimeve dhe debatit gjatë procesit të rishikimit duke ofruar tregues të qartë të mosplotësisht të detyrimeve ndërkombëtare nga shteti.
5. **Konsultohuni me rezultatet dhe rekomandimet e ciklit të mëparshëm** të rishikimit të shtetit. Raporti juaj duhet të përmbajë ecurinë e fazës follow-up duke përfshirë komente në lidhje me statusin e rekomandimeve dhe duke ofruar zgjidhje në rast të moszbatimit të tyre nga shteti. Në këtë rast, nëse ju i referoheni rekomandimeve specifike sugjerohet që të vendosni të dhëna të qarta identifikuese për të . (Raporti UPR, sesioni, shteti nën rishikim, paragrafi ku gjendet rekomandimi, numri i rekomandimit, shteti që ka bërë rekomandimin). Në këtë rast përdorni termat rekomandim “plotësisht i zbatuar” ; “i zbatuar pjesërisht”; “Në proces zbatimi”, “i pa përmbushur”.

Rekomandimet që duhet të monitorohen në rast të dhunës me bazë gjinore të dala nga sesioni i II i rishkimit të Shqipërisë lidhen me:

- a) Rrit shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe merr masa për të rritur ndërgjegjësimin e juristëve, policëve, gjyqtarëve mbi natyrën serioze të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. **(Australia)**
- b) Zbatoni në mënyrë të plotë Strategjinë Kombëtare mbi Barazinë Gjinore, Dhunën me bazë gjinore dhe Dhunën në familje dhe ngrini kapacitetet e policisë për ndjekur raste të tilla përmes programeve trajnuese shitesë për të ndihmuar policët të identifikojnë rastet e dhunës dhe të ndihmojnë të mbijetuarit prej saj. **(SHBA)**
- c) Vazhdoni të zbatoni Strategjinë Kombëtare mbi Barazinë Gjinore, Dhunën me bazë gjinore dhe Dhunën në familje **(Kina)**

Burimi: https://www.upr-info.org/database/index.php?limit=0&fSUR=2&fSMR=All&order=&orderDir=ASC&orderP=true&fIssue=All&searchReco=&resultMax=300&response=&action_type=&session=&SuRRgrp=&SuROrg=&SMRRgrp=&SMROrg=&pledges=RecoOnly

6. Përfshini në raport **informacion të besueshëm** dhe **të saktë** mbështetur në të dhëna zyrtare ose të aksesueshme. Gjithashtu përmendni në raport hapat pozitive të shtetit (ju ndihmojnë të forconi lidhjen me qeverinë), praktikat më të mira dhe më spas kaloni tek propozimet tuaja konkrete për zgjidhje.
7. **Bashkepunoni me organizatat e tjera.** Është e këshillueshme që raportet në UPR të dërgohen **në grup organizatash**. Kjo pasi ju keni më shumë hapësirë për të ngritur probleme dhe ofruar zgjidhje të cilat mund të ngrihen gjatë procesit të rishikimit. Kjo është gjithashtu një mundësi e mirë për t'u njohur, bashkëpunuar me organizata të tjera për të ndarë me to ekperiencat, sukseset, sfidat, vështirësitë. Megjithatë shumë OJF zgjedhin të dërgojë një raport individualisht duke e konsideruar si më të shpejtë dhe duke shmangur nevojën për të dakortësuar me organizatat e tjera listën e çështjeve që do të përfshihet në raport.
8. **Prioritizoni çështjet!** Duke qënë se numri i fjalëve që keni në dispozicion për të shkruar raportin është i vogël sugjerojmë që të veçoni ato çështje që sipas jush janë më shqetësuese e më problematike e që kanë nevojë për ndërhyrje sa më të shpejtë nga shteti në proces rishikimi.

Kujdes!

Mos rishkruani në Raportin tuaj Vërejtjet Përmbyllëse të hartuara nga Organe Ndërkombëtare ose procedurat e vecanta të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, pasi është ky i fundit që i përfshin ato në raportin e tij përmbledhës.

2.10 Pse është me rëndësi për mua si organizatë të lloj me shtetet e tjera?

Duke qënë se OJF mund të marrin pjesë, port ë mos flasin në sesionin e rishikimit, lobimi me shtetet e tjera mbetet nja nga hapat më me rëndësi të OJF në mënyrë që rekomandimet e tyre të merren parasysh nga shtetet

dhe të ngrihen gjatë rishikimit. Për këtë arsye sugjerojmë që jut ë identifikoni paraprakisht shtetet të cilat janë më të ndjeshme në lidhje me çështjet që ju keni ngritur dhe të vendosni takime me përfaqësues të ambasadave, konsullatave, misioneve diplomatike brenda vendit dhe/ose në Gjenevë.

Për të patur sukses gjatë lobimit me shtetet e tjera:

1. Përgatisni paraprakisht një listë të çështjeve dhe rekomandimeve që organizata juaj do të donte të ngriheshin gjatë dialogut interaktiv.
2. Shpërndajeni listën tek delegacionet e shteteve që ju i keni identifikuar për të lobuar në Gjenevë.
3. Zgjidhni për të lobuar me shtete që zakonisht bëjnë rekomandime dhe ngrenë çështje brenda fushës që ju intereson edhe juve. Psh Norvegjia, Danimarka dhe Sllovenia përgjithësisht ngrenë çështje të të drejtave të grave.

Burimi: Human Rights Project "A practical guide to the United Nations' Universal Periodic Review", 2010

Lobimi është një veprim që ju si organizatë mund ta bëni jo vetëm për qëllim të dialogut interaktiv, por edhe përpara miratimit formal të dokumentit final të rishikimit nga Këshilli. Në këtë fazë ju mund të loboni me përfaqësuesit e shtetit tuaj në mënyrë që ai të pranojë rekomandime specifike në lidhje me përmirësimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të grave në veçanti. Por nga ana tjetër kini kujdes pasi disa shtete në përputhje me zhvillimin dhe parimet e tyre mund të bëjnë rekomandime që bien ndesh me zhvillimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë e në këtë rast lobimi me shtetin duhet të ketë si qëllim mospranimin e rekomandimeve nga ky i fundit.

2.11 A mund të marr pjesë në sesionet e Grupit të Punës gjatë UPR?

Përgjithësisht OJF mund të ndikojnë në sesionet e Grupit të Punës në disa mënyra. Kjo pasi që një OJF të marrë pjesë në këtë proces duhet të gëzojë statusin e një organizatë të akredituar nga Këshilli Ekonomik Social. Në rast se nuk janë të akredituara OJF mund të organizojnë një takim/event një ditë përpara rishikimit, në të cilin të ngrenë çështjet që shqetësojnë shtetin nën rishikim në lidhje me garantimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu ju mund të kryeni takime edhe me qeverinë e shtetit tuaj të paktën 48 orë përpara fazës së dialogut interaktiv në mënyrë që përpigjeni të influenconi në vendimet e qeverisë për të pranuar ose jo rekomandime të caktuara. Ndërkohë që nëse ju merrni statusin e një OJF të akredituar atëherë mund të merrni pjesë në sesionet e Grupit të Punës, por pa të drejtë fjale.

Informacion mbi akreditimin e OJF në Sesionet UPR:

OJF me status konsultativ në Këshillin Ekonomik Social ë kanë dëshirë të marrin pjesë në sesionet e Grupit të Punës duhet të dorëzojnë tek Sekretariati i Këshillit një kërkesë akreditimi. Kërkesa depozitohet on line tek upraccreditation@ohchr.org .

Kërkesa duhet të përmbushë disa element për t'u marrë në konsideratë:

1. Duhet të dërgohet në formatin zyrtar të organizatës (me logon e saj).

2. Duhet të përcaktoni qartë titullin e sesionit dhe kohëzgjatjen e sisionit që ju doni të merrni pjesë. Psh (Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare me status konsultativ në Këshillin Ekonomik Social Kulturor, ka dëshirë të dërgojë këta anëtarë () për të marrë pjesë në Sesionin e tretë të Grupit të Punës gjatë UPR për Shqipërinë nga ...deri në...
3. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga Presidenti ose Përfaqësuesit kryesorë të organizatës në Gjenevë.
4. Kërkesa duhet të përmbajë të dhanat e personave që do të përfaqësojnë organizatën në Grupet e Punës.

Burimi: http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Documents/accreditation_NGOs.pdf.

2.12 A mund të ndërhyj unë si OJF në mbledhjen e Këshillit të të Drejtave të Njeriut pas procesit të rishikimit?

Çdo organizatë e akredituar mund të marrë pjesë në sesionin plenar të Këshillit që mbledhet 3-4 muaj pas sesionit të rishikimit. OJF në këtë fazë mund të bëjnë prezantime me gojë ose të paraqesin raporte të shkruara me qëllim që të bëjnë komente ose pyetje për shtetin nën rishikim përpara se të miratohet dokumenti përfundimtar i procesit të rishikimit. OJF kanë në dispozicion 20 minuta, nga të cilat çdo folësi i takojnë 2 minuta për të paraqitur prezantimin e tij. Nëse ju e keni të pamundur të shkoni në Gjenevë, atëherë mund t'iu jepet mundësia që të ndërhyni përmes një video mesazhi përmes të cilit të ngrini çështjet që doni të përfshihen në në dokumentin e miratuar. Ndërhyrja në këtë formë është e kufizuar për OJF me status në Këshillin Ekonomik e Social të cilat nuk kanë një zyrë ose përfaqësues në Gjenevë.

Çfarë duhet të bëni gjatë ndërhyrjeve me gojë?	Çfarë nuk duhet të bëni?
✓ Përmendi çfarë mungon nga Raporti Kombëtar dhe Dokumenti përfundimtar	☒ Mos flisni për situatën e të drejtave të njeriut në përgjithësi pa bërë asnjë referencë tek UPR;
✓ Sfidoni përgjigjet e dhëna nga shteti mbi pyetjet dhe rekomandimet;	☒ Mos harroni t'i referoheni Dokumentit Përfundimtar që do të miratohet;
✓ Referojuni rekomandimeve specifike që janë në raportin e Grupit të Punës	☒ Mos i bëni rekomandime shtetit nën rishikim;
✓ Nënvizoni çfarë ka thënë Shteti gjatë Grupit të Punës ose Sesionit Plenar;	☒ Mos harroni të inkurajoni shtetin të zbatojë rekomandimet që kanë dalë nga UPR.
✓ Respektoni kohën!	

Vini re!

Organizata juaj mund të dojë të ndajë deklaratën me gojë me Median me qëllim të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me shqetësimet që ju keni. Në këtë moment ky është një hap mjaft i rëndësishëm për t'iu ndjekur sepse sapo raporti të miratohet zyrtarisht do të fillojë edhe procesi i zbatimit të rekomandimeve nga shteti.

2.13 Çfarë roli kanë OJF në fazën Follow-up për të siguruar zbatimin e rekomandimeve nga shteti?

Në përfundim të procesit të rishikimit, shtetet janë përgjegjëse për të përmbushur konkluzionet, rekomandimet, zotimet që janë pjesë e produktit

final të procesit UPR. Megjithatë , OJF mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë fazë duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve nga ana e shtetit dhe duke bashkëpunuar me këtë të fundit me qëllim zbatimin e tyre. Disa nga strategjitë se si OJF mund të përfshihen në fazën Follow-up përfshijnë:

- 1. Organizoni një konferencë shtypi:** Në këtë mënyrë ju do të mund të bëni publike materiale që përmban dokumenti përfundimtar i rishikimit i cili është miratuar nga shteti juaj. Kjo nënkupton që ai ka pranuar rekomandimet dhe është zotuar për t'i përmbushur ato. Në këtë konferencë ju mund të nënvizoni edhe rekomandimet që nuk janë pranuar nga shteti për t'u përmbushur pas sesionit të rishikimit.
- 2. Përdorni median:** Përmes kësaj metode ju mund të përdorni si median online facebook, twitter, blogje të tjera me qëllim që të shpërndani produktin e arritur gjatë UPR dhe të ushtroni presion tek qeveria për të përmbushur rekomandimet që shtetet e tjera i kanë dhënë vendit tuaj.
- 3. Organizoni takime:** Diskutoni rëndësinë e produktit final të UPR për shtetin me shoqërinë civile, organizata të tjera, komunitetin për t'i bërë edhe ata pjesë të procesit të implementimit.
- 4. Hartoni një strategji për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve nga ana e shtetit:** Organizatat duhet të monitorojnë shtetin për një periudhë 4 vjeçare për të parë nëse a i ka përmbushur ose jo rekomandimet e dhëna. Kjo do t'iu shërbejë për të hartuar edhe raportin tuaj në sesionin e ardhshëm të rishikimit për shtetin tuaj.
- 5. Merrni pjesë në zbatimin e rekomandimeve:** Ju mund të hyni në bisedime me qeverinë për t'i ofruar asaj ekspertizën tuaj në fushën ku ushtroni veprimtarinë në mënyrë që rekomandimet të plotësohen brenda afatit. Përmes dialogimit ju mund të ndihmoni qeverinë në përcaktimin e planit të veprimit për të përmbushur rekomandimet që është zotuar t'i plotësojë.
- 6. Raportoni në lidhje me përmbushjen e rekomandimeve:** Monitorimi i zbatimit osë jot ë rekomandimeve iu hap rrugë OJF që të hartojnë raporte në sesionin e ardhshëm në lidhje me statusin e rekomandimeve, problemet dhe sfidat gjatë zbatimit si dhe duke ofruar zgjidhje për përmirësimin e situatës në vazhdim. Gjithashtu , ju mund të dërgoni raporte në lidhje me zbatimin e rekomandimeve edhe në afate të ndërmjetme pas dy vjetësh nga UPR i fundit. ³⁵

Ndërgjegjëso – Bashkëpunë – Raporto!

Ju mund të ndikoni në përmbushjen e rekomandimeve nga shteti përmes:

- 1.** Rritjes së Ndërgjegjësimit (Përdor median, konferenca shtypi, takime të hapura). Bëjini të njohura rezultatet e procesit për shoqërinë civile, parlamentarët, ambasadat, konsullatat, agjencitë e OKB në Shqipëri!
- 2.** Bashkëpunimit me qeverinë duke ofruar ekspertizën tuaj në fushë.
- 3.** Raportimit në lidhje me statusin e përmbushjes së detyrimeve nga shteti!

PJESA E TRETË

3. PJESËMARRJA E OJF NË PROCEDURËN E MONITORIMIT NGA GREVIO

Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)³⁶ është traktati i parë ndërkombëtar që krijon kornizën e detyrimeve ligjore të shteteve në përgjigje të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Shteti shqiptar është bërë palë e kësaj Konvente dhe detyrohet ta zbatojë atë prej 1 Gusht 2014.

Konventa është e ndërtuar mbi bazën e tre shtyllave kryesore:

- Parandalimin e Dhunës
- Mbrojtjen dhe Mbështetjen e viktimave të dhunës
- Ndëshkimin e dhunuesve

Shteti shqiptar ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme në ligj dhe praktikë për ta zbatuar Konventën e Stambollit në secilën prej shtyllave të saj. Procesi i vlerësimit të zbatimit të Konventës nga shteti realizohet përmes mekanizmit të monitorimit të krijuar nga Konventa i cili realizohet nga Grupi i Ekspertëve mbi veprimet ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO) dhe Komiteti i Palëve. Kjo pjesë e manualit do të përpiqet të orientojë OJF-të në lidhje me procesin e monitorimit të zbatimit të standardeve të Konventës së Stambollit nga shteti shqiptar.

3.1 Çfarë është GREVIO?

GREVIO është një organ i pavarur i specializuar në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, i krijuar për të monitoruar zbatimin e Konventës nga shtetet palë të saj. Ai harton një pyetësor mbi bazën e të cilit shtetet duhet të informojnë GREVIO-n në lidhje me masat ligjore dhe çdo masë tjetër që kanë marrë brenda vendit, me qëllim plotësimin e detyrimeve të vendosura nga Konventa. GREVIO mund të miratojë rekomandime të përgjithshme mbi konceptet dhe çështjet që mbulon konventa.³⁷

3.2 Çfarë është Komiteti i Palëve?

Komiteti i Palëve është i përbërë nga përfaqësues të palëve të Konventës. Bazuar në raportin e vlerësimit të GREVIO-s për shtetin palë, Komiteti i Palëve mund të miratojë rekomandime mbi masat që duhet të marrë shteti për të zbatuar konkluzionet që ka nxjerrë GREVIO në raportin e tij. Ai gjithashtu mbikqyr zbatimin e rekomandimeve nga shteti ³⁸.

36 Tekstin e plotë të Konventës së Stambollit mund ta konsultoni tek <https://rm.coe.int/168046246b>

37 Council of Europe, Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Monitoring mechanism, fq.2 në formatin online tek <https://rm.coe.int/16806fcd9d>

38 Council of Europe, Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Monitoring mechanism, fq.5 në formatin online tek <https://rm.coe.int/16806fcd9d>

3.3 Si realizohet procesi i monitorimit të Konventës nga GREVIO?

GREVIO harton një database për vlerësimin e çdo shteti palë të Konventës. Në çdo rast vlerësimi kalon në tre faza:

1. GREVIO i dërgon pyetësorin shtetit nën monitorim mbi zbatimin e Konventës. Shteti në këtë rast duhet të hartojë raportin e tij mbi bazën e pyetësorit të GREVIO-s. GREVIO gjithashtu mbledh informacione shtesë nga burime të tjera jo qeveritare (OJF, shoqëri civile, Avokati i Popullit etj)
2. GREVIO viziton shtetin nën monitorim. (Delegacioni i GREVIOs kryen takime me përfaqësues të qeverisë, OJF-ve, shoqërisë civile, viktimat/ të mbijetuara të dhunës në familje)
3. GREVIO harton draft raportin e vlerësimit dhe ia dërgon shtetit për komente. Pas komenteve të shtetit GREVIO harton Raportin e tij përfundimtar për shtetin palë i cili miratohet nga Komiteti i Palëve dhe bëhet publik.³⁹

FIRST EVALUATION PROCEDURE



3.4 Roli i OJF-ve në procesin e monitorimit të Konventës

Aktivizimi i organizatave jofitimprurëse në parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje luan një rol të rëndësishëm në zbatimin me efikasitet të Konventës së Stambollit. Konventa i detyron shtetet të njohin, inkurajojnë dhe mbështesin veprimtarinë e OJF-ve në fushën e të drejtave të

39 Council of Europe, Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Monitoring mechanism, në formatin online tek <https://rm.coe.int/16806fcd9d>

Shih gjithashtu Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO), Rules of Procedure tek <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

grave si dhe të rrisin bashkëpunimin me to për të përmirësuar situatën e të drejtave të grave në vend. Nga ana tjetër, OJF-të janë partnerë të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të Konventës nga shtetet palë.

Grupi i ekspertëve të veprimit mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (GREVIO) njeh dhe vlerëson kontributin e OJF-ve në të gjithë procesin e monitorimit të Konventës dhe përmbushjes së rekomandimeve për zbatimin efektiv të saj, duke i konsideruar ato si një burim kyç informacioni gjatë gjithë procesit. OJF-të mund të angazhohen në forma të ndryshme gjatë procesit të monitorimit të Konventës së Stambollit nga momenti i fillimit të procedurës së vlerësimit të shtetit nga grupi i ekspertëve të Këshillit të Evropës.⁴⁰

Vlerësimi fillestar i shteteve mbi zbatimin e Konventës bëhet mbi bazën e plotësisht të pyetësorit të GREVIOS nga ana e shteteve palë. Në këtë fazë GREVIO fton OJF-të të bëhen pjesë e procesit, duke i dërguar atij informacion shtesë bazuar në raportin e shteteve.⁴¹ Gjithashtu, GREVIO mund të vizitojë shtetin nën monitorim për të vlerësuar më nga afër nivelin e zbatueshmërisë së Konventës në vend. Gjatë kësaj faze, përfaqësuesit e GREVIO-s mund të zhvillojnë takime me përfaqësues të OJF-ve të fushës ose të organizojnë dëgjesa për OJF-të, me qëllim që të dëgjojnë zërin e tyre në lidhje me problematikat më shqetësuese në vend për çështjet e mbuluara nga Konventa.

3.5 Pse është e rëndësishme për OJF të marrin pjesë në procedurën e monitorimit të GREVIO-s?

Pjesëmarrja juaj si OJF në procedurën e monitorimit të GREVIO mund të ndikojë në përmirësimin e situatës së grave dhe në promovimin e standarteve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave brenda vendit.

- Ju mund të ndikoni në procesin e vlerësimit të GREVIO për Shqipërinë dhe në **hartimin e rekomandimeve përfundimtare** për shtetin.
- Për shkak të veprimtarisë tuaj, **ju zotëroni informacion të përditësuar** dhe të pasur me **eksperienca të drejtëpërdrejta** të shkeljes së të drejtave të grave.
- Ju mund të **ndërtoni ura komunikimi** midis Këshillit të Evropës dhe aktorëve politikë në vend.
- Ju mund t'i jepni mekanizmit të monitorimit të KE informacion të pasur me **të dhëna statistikore dhe analitike** të mbledhura gjatë veprimtarisë tuaj në këtë fushë që mund të hedhin dritë mbi trendet dhe problematikat në ligj dhe praktikë.
- Ju mund të ndikoni pozitivisht në punën dhe efikasitetin e mekanizmit të monitorimit me qëllim zbatimin efektiv të konventës së Stambollit.⁴²

40 Council of Europe "The role of NGO's in the first (baseline) evaluation procedure of the implementation of the Istanbul Convention" tek <https://rm.coe.int/ic-inf-2016-4-eng/168071363e>, 2016

41 Shih Rregullin Nr.35 të Rregullave të Procedurës së GREVIO-s tek <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

42 Shih për më tepër raportin e Takimit të Ekspertëve të Barazisë Gjinore, 28 Janar 2016, tek <https://accessdotorg.files.wordpress.com/2015/10/factsheet-gender-equality-meeting-coe-28-january-2016.pdf>

3.6 Si mund të marr pjesë unë si OJF në procesin e monitorimit të GREVIO-s?

Ju mund të bëheni pjesë aktive e procesit të monitorimit të GREVIO duke ndjekur një ose disa nga mundësitë e mëposhtme:

- Ju mund t'i dërgoni **raporte alternative ose hije GREVIO-s** duke iu përgjigjur të gjitha ose disa pjesëve të pyetësorit të shtetit;
- Pas publikimit të raportit të shtetit, ju mund t'i ofroni mekanizmit të monitorimit **informacion ose të dhëna shtesë që mungojë ose janë kontradiktore në raportin e shtetit**;
- Ju mund t'i ofroni GREVIO-s informacion të rëndësishëm për ta ndihmuar atë në **përgatitjen dhe identifikimin e prioritetëve për shtetin që po monitoron** ⁴³;
- Ju mund të keni mundësi të **takoheni me përfaqësuesit e GREVIO-s** gjatë vizitave në shtetin tuaj për të sjellë në vëmendjen e tyre situatën reale të të drejtave të grave në vend.⁴⁴
- Ju mund të angazhoheni **në dialogun me aktorët politikë** në vend duke i ofruar ekspertizën tuaj në lidhje me zbatimin në kohë të rekomandimeve të GREVIO-s.⁴⁵
- Ju mund të bëheni **pjesë aktive e procedurës follow-up** duke monitoruar dhe ose ndihmuar shtetin në përmbushjen e rekomandimeve të GREVIO-s.⁴⁶

Sipas **Nenit 68(5)** të Konventës “ *GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, si edhe nga institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.*”

Pjesëmarrje e OJF-ve në të gjithë procesin e monitorimit nga GREVIO:

1. Brenda afatit të raportimit të shtetit

Hartoni raporte të veçanta ose në koalicione me OJF-të dhe ndajini ato me GREVIO-n brenda datës së raportimit të shtetit

2. Pas publikimit të raportit të shtetit

- Dërgoni raporte hije mbi raportin e shtetit duke ndarë me GREVIO-n informacione, të dhëna, komente në reagim të raportit të shtetit
- Përpuni të dërgoni raportet sa më parë pas publikimit të raportit të shtetit dhe përpara se GREVIO të nxjerrë vlerësimin e tij mbi raportin e shtetit

3. Përpara dhe gjatë vizitave të përfaqësuesve të GREVIO-s:

- Merrni pjesë në tryezat e organizuara nga delegacioni i GREVIO-s

43 Shih Rregullin35, 40.1, 47.2 dhe 54 të Rregullave të Procedurës të GREVIO tek <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

44 Shih Rregullin35, 40.1, 47.2 dhe 54 të Rregullave të Procedurës të GREVIO tek <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

45 Shih Rregullin35, 40.1, 47.2 dhe 54 të Rregullave të Procedurës të GREVIO tek <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

46 Shih për më tepër raportin e Takimit të Ekspertëve të Barazisë Gjinore, 28 Janar 2016, tek <https://accessdotorg.files.wordpress.com/2015/10/factsheet-gender-equality-meeting-coe-28-january-2016.pdf>

- Përgatisni informacion me shkrim për delegacionin mbi problematikat në zbatimin e Konventës nga shteti
 - Lehtësoni organizimin e vizitave të GREVIO-s në vendet me interes për delegacionin (psh:strehëzat e grave)
 - Asistoni në organizimin e takimeve me profesionistë të fushës
 - Lehtësoni takimet e delegacionit me viktimat e dhunës në familje
4. **Pas publikimit të raportit të GREVIOS:**
Promovoni Raportin e GREVIO-s dhe shpërndajeni atë
 5. **Pas Publikimit të Rekomandimeve të Komitetit të Palëve:**
Promovoni Rekomandimet
 6. **Vlerësimi Follow-up:** Jepni informacion mbi veprimet/mosveprimet e shtetit mbi zbatimin e rekomandimeve

Burimi: Council of Europe “The role of NGO’s in the first (baseline) evaluation procedure of the implementation of the Instambul Convention”, 2016.

3.7 Kur mund t’i dërgoj unë si OJF informacion GREVIO-s?

OJF mund të informojnë GREVIO-n në çdo kohë në lidhje me zbatimin e Konventës të Stambollit nga shteti palë. Ato mund të informojnë GREVIO-n edhe përpara se ai të vendosë të vlerësojë shtetin dhe të përcaktojë afatin për raportimin e tij. Megjithatë, në rast të përcaktimit të afateve për raportimin e shtetit, GREVIO vlerëson me rëndësi dërgimin e raporteve të OJF-ve brenda të njëjtave afate. OJF-të duhet të jenë të kujdesshme të përgatisin informacionin në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frengjisht).

3.8 Si duhet ta strukturoj raportin për GREVIO-n? A duhet të raportoj mbi të gjitha nenet e Konventës?

Shumica e OJF-ve në hartimin e raportit të tyre bazohen në pyetësin e përgatitur nga GREVIO për raportimin e shtetit.

- Megjithëse pyetësi mund t’iu ndihmojë të strukturoni raportin tuaj për GREVIO-n njëllor si ai shtetit, ju **NUK** jeni të detyruar të raportoni mbi të gjitha aspektet e Konventës ose mbi të gjitha pyetjet e pyetësit të GREVIO-s.
- Përpara se ta hartoni raportin rekomandohet të lexohet me kujdes **Raportin Shpjegues të Konventës** së Stambollit tek <https://rm.coe.int/16800d383a> për të kuptuar më mirë detyrimet e shtetit për zbatimin e Konventës.
- Fokusojeni raportin tuaj në zbatimin praktik të Konventës.
- Informacioni i dhëna nga ju duhet të jetë **Konciz** dhe **Preçiz**. **Mbështeteni raportin me të dhëna të sakta statistikore** ose të mbledhura nga ju.
- Përfshini në raport **zhvillimet pozitive mbi zbatimin e Konventës** dhe më pas **shqetësimet tuaja** në fushën që ushtroni veprimtarinë.
- Jepni **rekomandime konkrete** për përmirësimin e situatës.

Nga eksperiencat e disa Organizatave të huaja është konstatuar se OJF mund ta kenë më të lehtë të strukturojnë raportin e tyre mbi zbatimin e Konventës së Stambollit në bazë të çështjeve mbi të cilat kanë ekspertize dhe jo sipas cdo pyetjeje të pyetësorit të përgatitur nga GREVIO për këtë qëllim. Sipas tyre është më e vështirë për organizatat t’i referohen në cdo rast pyetësorit.

Koalicioni austriak i OJF-ve nga eksperiencia e tij në hartimin e raporteve rekomandon OJF e tjera që të mos ndjekin pyetësorin e GREVIOS për shtetin në hartimin e raportit tuaj. “Ju mund të raportoni për disa ose më shumë çështje se sa janë përfshirë në pyetësor. Pyetësori është i detyrueshëm për shtetin dhe jo për OJF-të. (Rekomandim i Koalicionit Austriak të OJF)

Struktura e Raporti të OJF-ve:

- Hyrje:** Jepni informacion të përgjithshëm mbi situatën e grave në Shqipëri
 - o Fakte dhe të dhëna statistikore mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje
 - o Informacion mbi indikatorët e tjerë të barazisë gjinore: arsimi/pjesëmarrja politike/paga/aksesi në shërbime

2. Ndiq strukturën e Konventës.

Për secilin Nen që kërkon të raportosh përcakto:

Të dhëna mbi situatën faktike

Përpiquni të jeni sa më konciz
Fokusohuni në çfarë nuk funksionon

Cilat janë problematikat dhe sfidat

Mangësitë e shtetit në zbatimin e Konventës
Jepni rekomandime konkrete
Propozoni zgjidhje konkrete për situatat bazuar në kontekstin kombëtar

Rekomandimet që ju propozoni

Rekomandimet të referohen tek autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

3.9 A i bën publike GREVIO informacionet që unë si OJF i jap?

Informacioni që ju i jepni GREVIO-s mbetet **Konfidencial**.⁴⁷ Po kështu kini parasysh që GREVIO ruan të fshehtë edhe informacionin që ju i jepni gjatë vizitave të delegacionit të tij brenda vendit. Në këtë mënyrë, **JU jeni të mbrojtur** në lidhje me informacionin që i jepni GREVIO-s, në lidhje me zbatimin e Konventës së Stambollit. Vetëm nëse ju vendosni që informacioni mund të bëhet publik, GREVIO mund të tregojë burimin nga e ka marrë informacionin gjatë dialogut me shtetin.

47 Council of Europe “The role of NGO’s in the first (baseline) evaluation procedure of the implementation of the Istanbul Convention” tek <https://rm.coe.int/ic-inf-2016-4-eng/168071363e>, document IC/Inf (2016)4

3.10 A mund të kem vështirësi unë si OJF në pjesëmarrjen aktive në procesin e monitorimit?

Për shkak të natyrës së veçantë të Konventës së Stambollit, ju duhet të keni parasysh që gjatë angazhimit tuaj në procedurën e monitorimit të GREVIO-s mund të haseni me disa vështirësi në lidhje me:

- Sigurimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, për shkak të nivelit të ulët të raportimit të tyre;
 - **Angazhohuni në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për raportimin e rasteve të dhunës dhe përditësoni të dhënat tuaja në lidhje me këto raste.**

Raportimi në lidhje me të gjitha nenet e konventës kërkon ekspertizë dhe kapacitete në lidhje me të gjitha fushat që mbulon konventa. **Nëse keni dëshirë të raportoni në lidhje me zbatimin e të gjitha neneve të Konventës, sugjerohet të bashkoheni në koalicione me OJF të tjera të fushës për të ndarë burimet dhe ekspertizën tuaj në lidhje me zbatimin e Konventës së Stambollit.**

- Kujdes, ndërhyrjen në veprimtarinë tuaj të OJF-ve të përkrahura nga qeveria, të cilat mund të zbehin impaktin tuaj në lidhje me raportimin e problemeve sistemike dhe shkeljen e detyrimeve nga shteti.
 - **Rruani pavarësinë dhe mbani kontakte të vazhdueshme me GREVION duke i siguruar informacion të përditësuar dhe koherent për të rritur besueshmërinë dhe ndikimin tuaj tek ky mekanizëm.**

3.11 Çfarë mund të bëj unë si OJF për të rritur ndikimin tim tek GREVIO?

- Koordinoni dërgimin e raporteve alternative/hije me OJF-të e tjera të fushës me qëllim shmangjen e dublikimit të informacionit dhe problematikave. *Në këtë mënyrë, ju mund të arrini që raporti i përgatitur nga ju të merret në konsideratë nga GREVIO.*
- Informoni OJF-të dhe shoqërinë civile në lidhje me mundësinë për t'u përfshirë në procesin e monitorimit të GREVIO.
- Ofroni mbështetje dhe ose trajnime për OJF-të e reja në fushë në lidhje me Konventën e Stambollit, GREVIO-n si mekanizëm i monitorimit të Konventës.
- Merrni në konsideratë ndërtimin e një rrjeti të përbashkët të monitorimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe dërgoni raporte të përbashkëta tek GREVIO, me qëllim që të ngrini zërin mbi problemet më shqetësuese të evidentuara nga të gjitha OJF e rrjetit.

- Me qëllim që të rrisni ndikimin tuaj tek GREVIO, përpiquni të angazhoheni në mënyrë sistematike në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të promovoni rekomandimet dhe gjetjet e GREVIOs përmes punës suaj advokuese në nivel kombëtar.⁴⁸

3.12 Cilat janë masat urgjente të identifikuar nga GREVIO për të cilat duhet të raportojë Shqipëria dhe që do të bëhën burim i monitorimit nga ana juaj si OJF?⁴⁹

Rekomandimi 1

(Kapitulli I, Neni 2- Objekti i Konventës

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të ecin përpara me masat e tyre për dhunën ndaj grave duke garantuar që masat e marra në përputhje me Konventën e Stambollit të trajtojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore. (paragrafi 4)

Rekomandimi 2

(Kapitulli I, Neni 3 – Përkufizimet referuar Dhunës në Familje)

GREVIO i nxit (i inkurajon fuqishëm) autoritetet shqiptare të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë masat legjislative, për të harmonizuar përkufizimin e dhunës në familje brenda të drejtës familjare me Konventën, dhe për të garantuar një zbatim efikas të një përkufizimi të tillë të harmonizuar në praktikë. Autoritetet duhet të prezantojnë një qasje të qartë gjinore në legjislacionin e tyre për të pranuar tërësisht natyrën gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat (paragrafi 9)

Rekomandimi 10

(Kapitulli 2/D, Neni 11 – Mbledhja e e të dhënave dhe studimet, pika 1.

GREVIO i nxit (inkurajon fuqishëm) autoritetet shqiptare të:

- a. kategorizojnë dhe pasqyrojnë në mënyrë më të qartë të dhënat për dhunën në familje ndaj grave dhe natyrën e gjinizuar të formave të tjera të dhunës ndaj grave, në statistikën e publikuar për krimet, duke identifikuar qartazi numrin e grave viktime për çdo lloj veprë. Kjo mund të përfshijë paraqitjen e qartë të informacionit ndaj publikut për numrin e vrasjeve të grave nga burrat (vrasjet e grave të lidhura me gjininë);
- b. zhvillojnë kategori të dhënash, për sa i përket llojit të marrëdhënies ndërmjet dhunuesit dhe viktimës, për të gjitha format e dhunës ndaj grave, që do të mundësonte dokumentimin më të qartë të natyrës së marrëdhënies së tyre.

48 Raport nga Gender Equality Meeting, Council of Europe, Strasbourg, France 28 Janar 2016.

49 Raportin e plotë të GREVIO-s për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, miratuar në 12 Tetor 2017 mund ta konsultoni tek <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

- c. sigurojnë që këto kategori dhe çdo kategori tjetër të dhënash në përdorim, duke përfshirë edhe llojin e dhunës dhe vendndodhjen ku është kryer vepra, të harmonizohen në shumë sektorë;
- d. kryejnë studime për masën e dënimeve për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të publikojnë rezultatet e studimeve të tilla (paragrafi 41)

Rekomandimi 30

(Kapitulli 5, Neni 29 – Paditë civile dhe mjetet ligjore)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a. përfshijnë elemente që lidhen me përgjegjësinë civile të nëpunësve publikë, në informacionin që u ofrohet viktimave, në pajtim me Nenin 19⁵⁰;
- b. deklarojnë qartë në kodet e sjelljes parimin e përgjegjësisë civile të nëpunësve publikë, si dhe të rritin ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me të, si për shembull gjatë trajnimeve përkatëse;
- c. monitorojnë progresin në këtë fushë duke mbajtur të dhëna për numrin e padive civile dhe rezultatit e tyre.

GREVIO fton më tej autoritetet të vlerësojnë se cilat janë arsyt mbizotëruese që pengojnë viktimat të kenë qasje në mjetet juridike civile kundër autoriteteve shtetërore dhe, mbi bazën e këtyre gjetjeve, të marrin masa për të trajtuar shkaqet. Këto masa mund të jenë, për shembull, ngritja e një sistemi specifik që i mundëson përdoruesit e gjykatave të marrin kompensim pas mosfunksionimit të sistemit gjyqësor që i ka dëmtuar (paragrafi 114)

Rekomandimi 32

(Kapitulli 5/A, Neni 31/3 – Kujdestaria dhe të drejtat e vizitave)

GREVIO i nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet:

- a. të sigurojnë që, në çdo rast, përcaktimi të mënyrave të ushtrimit të të drejtave të kujdestarisë dhe të vizitave të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 31. Për këtë qëllim, autoritetet duhet:
- b. të pyesin kryesisht nëse, në rast të një kërkesë për urdhër mbrojtje të një viktime të dhunës në familje përfshihen fëmijë, si dhe të shqyrtojnë nëse edhe për ta duhet të lëshohet një urdhër mbrojtje;
- c. në kuadër të çdo vendimi për të lëshuar një urdhër mbrojtje ose një vendim tjetër gjyqësor që vendos për çështje familjare ku ka pasur/ ka dhunë (si për shembull, në rastet e ndarjes ose divorcit), të bëjnë përcaktimet e duhura në lidhje me të drejtat e kujdestarisë dhe të vizitave, duke i kushtuar rëndësi të veçantë dhunës dhe interesit më të lartë të fëmijës, sipas një vlerësimi rast pas rasti;
- d. të korrigjojnë çdo boshllëk që mund të ketë në ligj për zgjidhjen e të drejtave të kujdestarisë dhe të vizitave, gjatë çdo procesi gjyqësor, siç është rasti i apelit kundër vendimit për divorc;
- e. të sigurojnë që zbatimi i urdhrave për pasjen e kontaktit nuk i ekspozon viktimat dhe fëmijët e tyre ndaj një rreziku të mëtejshëm;

50 Neni 19: "Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të marrin informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet e disponueshme mbështetëse dhe masat ligjore"

f. të monitorojnë praktikën e gjykatave në këtë fushë dhe të matin progresin (paragrafi 121)

Rekomandimi 34

(Neni 36 – Dhuna seksuale përfshirë përdhunimin)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a.** ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që të bazohet në mungesën e lirisë së dhënies së pëlqimit dhe të mos kërkojë demonstrim të përdorimit të forcës apo rezistencës;
- b.** ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit që përfshin fëmijët ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjecare, në mënyrë që të bazohet në mungesën e një pëlqimi të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrim të përdorimit të forcës ose rezistencës. Në vlerësimin e pëlqimit të plotë dhe të lirë të fëmijës, konsideratë e duhur duhet t'i kushtohet hendekut të moshës ndërmjet përdhunuesit dhe viktimës;
- c.** ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit që përfshin fëmijët ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjecare, në mënyrë që të mos varet nëse viktima ka arritur apo jo moshën e pjekurisë;
- d.** kriminalizojnë sjelljen seksuale pa dhënien e pëlqimit, të përshkruar në paragrafin 1, gërmat b dhe c të nenit 36 të Konventës;
- e.** miratojnë masat e nevojshme për të siguruar që çdo krim i dhunës seksuale ndiqet dhe zbatohet ndërmjet ish-bashkëshortëve ose bashkëshortëve aktualë, ose partnerëve, siç njihen nga ligji i brendshëm (paragrafi 139)

Rekomandimi 43

(Kapitulli V/B, pika 10, Neni 48/b Pajtimi në procedurat civile)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë ndryshimin në legjislacioni përkatës, për të:

- a.** përjashtuar qartësisht zbatueshmërinë e procedurës së pajtimit gjatë rrjedhës së procedurës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes;
- b.** vendosur parimin se pajtimi nuk mund të jetë i detyrueshëm në procedurat e divorcit, ku ka dhunë;
- c.** përfshirë një vlerësim të rrezikut dhe të masave mbrojtëse për të siguruar pëlqimin e plotë dhe të lirë të viktimës në kuadër të çfarëdo procedure të pajtimit vullnetar (paragrafi 175)

Rekomandimi 45

(Kapitulli VI/B, Neni 51 – Vlerësimi i rrishtit dhe menaxhimi i rrishtit)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të zhvillojnë procedura të standardizuara për vlerësimin dhe menaxhimin e rrishtit të vdekshmërisë dhe dhunës së përsëritur për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa, dhe të ofrojnë trajnime në përputhje me to. Këto procedura duhet të kthehen në kryesore për reagimin e koordinuar shumë-sektorial të mekanizmave të referimit në Shqipëri dhe të vihen në dispozicion të të gjithë profesionistëve që hyjnë në kontakt me viktimat (paragrafi 182)

Rekomandimet 46 dhe 47

(Kapitulli VI/C, Neni 52 dhe 53 – Urdhrat e jashtëzakonshëm dhe urdhrat mbrojtës)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a. rishikojnë dispozitat ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM-të të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës;
- b. pa cenuar nevojën për siguri të menjëhershme të viktimave, të integrojnë, në procedurën e lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat të mbrojtjes, vlerësimin e rrezikut;
- c. promovojnë një rol më aktiv të agjencive të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave, duke i nxitur ato të shfrytëzojnë të drejtat e tyre teksa respektojnë zgjedhjet e informuara të viktimave;
- d. sigurojnë ekzekutimin efektiv të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes nga ana e agjencive përgjegjëse, në veçanti përmbaruesve;
- e. ndjekin penalisht dhunuesit që shkelin urdhrat e mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhrat e mbrojtjes, si dhe të zbatojnë dënimet penale përkatëse;
- f. nxjerrin para përgjegjësisë nëpunësit që nuk zbatojnë urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat e mbrojtjes, duke zbatuar dënimet penale përkatëse;
- g. identifikojnë fushat e mëtejshme ku ka vend për përmirësim duke analizuar arsyet e numrit të lartë të viktimave që kërkojnë mbrojtje me anë të mekanizmit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrat të mbrojtjes (paragrafi 188)

Duke marrë parasysh kërkesën e nenit 53 që urdhrat e kufizimit ose të mbrojtjes të vihen në dispozicion të viktimave të të gjitha formave të dhunës që mbulon Konventa, GREVIO i nxit më tej (kërkon më tej sa më parë nga) autoritetet të paraqesin forma të tjera të mbrojtjes së viktimave të dhunës ndaj grave, përveç dhunës në familje (paragrafi 189)

Rekomandimi 48

(Kapitulli VI/C, Neni 52 dhe 53 – Urdhrat e jashtëzakonshëm dhe urdhrat mbrojtës)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që, në bashkëpunim të ngushtë me Urdhrin e Psikologëve, të marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

- a. në të gjitha rastet kur lëshohet një urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës në familje, gjendja e të miturve dëshmitarë të shqyrtohet sistematikisht, pavarësisht nga kërkesa specifike e kërkuesit, për të përcaktuar nëse duhet edhe ata të përfitojnë nga urdhri i mbrojtjes;
- b. raportet psikologjike të paraqitura para gjykatave t'i përgjigjen kriterëve të kërkuara të profesionalizmit dhe objektivitetit;
- c. tarifat e raportit të detyrueshëm psikologjik të mos përbëjnë pengesë për të pasur qasje në drejtësi (paragrafi 191)

Rekomandimi 49

(Kapitulli VI/D, Neni 52 paragrafi 1 – Procedimet Ex parte and ex officio)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të amendojnë dhe sjellin legjislacionin shqiptar në përputhje me rregullat në lidhje me ndjekjen ex parte dhe ex officio të përcaktuara në nenin 55, paragrafi 1 të Konventës (paragrafi 198)

Rekomandimi 51

(Kapitulli VI/F, Neni 57 – Ndihma ligjore)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të:

- a. krijuar dhe financuar në mënyrë adekuate një sistem efektiv të ndihmës juridike për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa, bazuar edhe në përfshirjen e avokatëve të trajnuar në mënyrë adekuate;
- b. siguruar që viktimat të informohen siç duhet për të drejtën e tyre për të pasur akses në ndihmë juridike;
- c. njohur, mbështetur dhe promovuar punën e OJF-ve të specializuara në prokurimin e ndihmës juridike për viktimat (paragrafi 206).

SUGJERIME:

Për të hartuar raportin tuaj në lidhje me procedurën follow-up pas vlerësimit të parë të GREVIO për Shqipërinë:

1. Raporti shpjegues i Konventës ndihmon për të kuptuar se si e trajton Konventa konceptin e dhunës ndaj grave dhe çfarë detyrimesh kanë shtetet në bazë të Konventës;
2. Përcaktoni prioritetet që ju keni në lidhje me adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore/ Zgjidhni ato nene të konventës mbi të cilat mendoni të raportoni;
3. Përfundimet e vlerësimit të parë të GREVIO-s për Shqipërinë do tju ndihmojnë për çështjet që ju i keni në interes;
4. Mblidhni të dhëna që mbështesin argumentat tuaja dhe koordinoni punën edhe me OJF-të e tjera që ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtën fushë me ju;
5. Kërkoni informacion nga autoritetet qeveritare në lidhje me masat që janë duke marrë për zbatimin e rekomandimeve të GREVIO-s.
6. Hartoni një plan tuajin masash për adresimin e zgjidhjeve dhe loboni me autoritet qeveritare për t'i marrë ato parasysh;
7. Caktoni një person i cili do të merret me bashkimin e kontributeve të të gjitha OJF-ve dhe redaktimit të tyre për të mos pasur mbivendosje
8. Hartoni raportin tuaj në lidhje me masat e marra nga ana e shtetit dhe përgatisni një përmbledhje të tij për ta bërë publike dhe për ta promovuar në media, rrjete sociale.

3.13 Rast Studimor: Shkëputur nga Modeli austriak/ Struktura e Raportit Hije të OJF

Neni 8 i Konventës: Burimet Financiare

Teksti i Konventës

Palët shpërndajnë burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e duhur të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato që zbatohen nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile.

Background

- Konventa e Stambollit kërkon shpërndarjen e duhur të burimeve financiare
- Kjo nënkupton që autoritetet shtetërore duhet të parashikojnë shumën e të ardhurave të nevojshme për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Sfidat

- Studimi i BE në 2011 parashikon që kostoja totale e dhunës me bazë gjinore do të jetë afërsisht 228 bilion Euro, 450 euro për qytetar në vit
- Ka pak informacion në lidhje me sasinë e parave që po investohen aktualisht në Austri për mbrojtjen e dhunës ndaj grave
- Buxheti vjetor i Ministrisë së Shëndetit dhe Punëve të Grave parashikon vetëm 10 milion euro për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe barazisë gjinore

Rekomandime

- **Llogaritje:**
 - ✓ Dhuna kushton 450 euro për njeri në vit
 - ✓ Të paktën 10% e këtyre kostove shpenzohet për parandalimin e dhunës
 - ✓ Edhe nëse e zvogëlojmë këtë shifër dhe e shndërrojmë 250 euro
 - ✓ Kjo nënkupton që duhen 25 euro për çdo qytetar austriak
 - ✓ Në total duke llogaritur numrin e popullsisë: 210 milion euro
- Për sa më sipër rekomandojmë që buxheti i Ministrisë së grave të rritet në 210 milion euro
- Fondë shtesë të nevojshme nevojiten të merren në të gjitha ministrinë e tjera dhe në nivel lokal
- Fondi për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje duhet të ketë një bazë ligjore ku të parashikohet se çdokush që është viktime e dhunës ka të drejtën për të përfutur mbështetje nga fondet qeveritare.

Burimi: Association of Austrian Autonomous Women's Shelters, AÖF & Domestic Abuse Intervention Centre Vienna, IS, Austrian GREVIO NGO Shadow Report, Vienna, 2016, fq 15. http://files.wave-network.org/home/Austria_NGOGREVIOShadowReport_September2016.pdf

SHTOJCA

Shtojcë.1

Vështrim krahasues i raporteve hije të organizatave të huaja: Shembuj të mirë (Austria/Australia), Praktika për t'u përmirësuar (Egjypt/ Meksika)⁵¹

Përpara hartimit të raportit hije është e këshillueshme për OJF-të që të konsultohen edhe me praktikant dhe shembujt pozitiv të OJF të shteteve të tjera në mënyrë që raporti i tyre të jetë sa më efektiv si për Komitetin CEDAW ashtu edhe për përmirësimin e situatës së grave në vend. Gjithashtu vështrimi i raporteve të cilësuar si shembuj jo shumë të mirë për t'u ndjekur është me interes pasi analiza e tyre mund t'i orientojë më mirë OJF-të për të hartuar raportin e tyre duke shmangur paqartësinë apo problematikat që mund të evidentohen në këto praktika “jo aq pozitive”.

Analiza është bërë mbi bazën e disa treguesve që lidhen me:

- Strukturimin dhe organizimin e raportit hije
- Mënyra e të shkruarit
- Mbështetja e përfundimeve në të dhëna/ fakte
- Qartësia e raportit
- Mënyra e hartimit të rekomandimeve

Tabela më poshtë jep të dhëna në lidhje me mënyrën se si janë përmbushur këta tregues në secilin prej raporteve të marra shembull. Ju mund të konsultoheni me raportet e plota të këtyre organizatave në formatin elektronik të raporteve në website-t e poshtëshënuara.

51 Për një analizë më të plotë shih Capstone Team, School of International and Public Affairs (2015) “A comprehensive analysis and guide for using hije and alternative reports to hold States Parties accountable for violations of gender-based violence under CEDAW, with a particular focus on Myanmar” Columbia University

Treguesit	Shtetet	Australia	Egjipt	Austria	Meksika
Autori	Cila është organizata që e ka shkruar raportin?	Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut	Shoqata Egjiptiane për Rritjen e Përfaqësimit të Komunitetit EACPE (2009)	Koalicioni i OJF për zbatimin e CEDAW në Austri (2012)	Koalicioni i OJF-ve (Qendra për të Drejtat e Grave dhe Drejtësi për bijat tona)
Organizimi i raportit	Si është organizuar raporti? Ka ndjekur strukturën sipas Neneve të Konventës CEDAW apo është tematik?	Tematik : Mbi dhunën ndaj grave/ dhunën në familje	I organizuar sipas Neneve të Konventës CEDAW	I organizuar sipas Neneve të Konventës	Raport Tematik: Lufta ndaj Drogës
Efektshmëria	A janë rekomandimet efektive, bindëse? Praktike? A referojnë organet që duhet t'i zbatojnë ato?	Përmban rekomandime praktike, të mundshme për t'u realizuar duke përcaktuar edhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.	Përmban rekomandime shumë të gjata, jo shumë të fokusuara. Disa prej rekomandimeve janë të vështira për t'u përbushur dhe në raport nuk sugjerohen rrugët se si mund të arrihet realizimi i tyre nga shteti.	Struktura shumë e qartë, përmban rekomandime specifike për çdo Nen. Efektiv pasi përcakton qartë detyrimet e shtetit për çdo Nen, sfidat dhe rekomandimet përkatëse.	Jo efektiv, nuk përmban asnjë rekomandim. Është i vështirë për t'u ndjekur pasi kalon nga rekomandimet që ka lënë CEDAW tek situata në përgjithësi në Meksikë dhe nuk përcakton sfidat, problematikat apo rrugët për zgjidhjen e tyre.
Të dhëna	Çfarë lloj të dhënash përman raporti? Cilësore/. Sasiore? A i bazon konkluzionet në shembuj praktikë?	Përman konkluzione të bazuara në të dhëna sasiore	Dy raste studimore	Të dhëna sasiore + cilësore (analizë legjislativore)	Përmban të dhëna sasiore të paraqitura në disa raste në grafikë.
Mënyra e të shkruarit	Si është shkruar raporti? I shkruar mirë/dobët? A përman tituj të qartë për cdo çështje?	I shkruar mirë, përmban tituj të ndarë e të qartë për çdo paragraf, i lehtë për t'u kuptuar	I organizuar mirë, por jo i formatuar mirë.	I shkruar qartë dhe i formatuar shumë mirë. I thjeshtë për t'u kuptuar.	Nuk është i shkruar qartë dhe jo i strukturuar sipas orientimeve të Komitetit CEDAW

Treguesit	Shtetet	Austria	Egjpt	Austria	Meksika
Komente		<p>Është një shembull i mirë raportimi për t'u ndjekur nga OJF : Tregon çfarë është arritur gjatë periudhës së monitorimit nga shteti, cilat janë sfidat, cilat janë hapat që duhet të ndiqen për të përmirësuar situatën, rekomandimet duke targetuar aktorët përkatës.</p>	<p>Raport shumë i gjatë. Rekomandimet nuk janë shumë specifike.</p>	<p>Rasti austriak është një shembull i mirë për t'u konsultuar nga OJF në lidhje me shkrimin e raporteve hije. Përmban një strukturë shumë të qartë dhe për çdo Nen përcakton shkurt dhe në mënyrë specifike : cilat janë detyrimet e shtetit, çfarë rekomandimesh ka lënë Komiteti, cilat janë sfidat dhe si mund të përmirësohen detyrimet. Rekomandime të shkurtra, të qarta dhe specifike.</p>	<p>Praktikë për t'u përmirësuar, jo e efektshme për t'u ndjekur nga OJF-të në përgatitjen e Raportit hije.</p>
Burimi ku mund ta gjejmë		<p>http://www.humanrights.gov.au/independent-interim-report-cedaw</p>	<p>http://www.wluml.org/sites/wluml.org/files/Hije%20Report%20CEDAW%20EACPE.pdf</p>	<p>http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/AUT/INT_CEDA%20NGO_AUT_13221_E.pdf</p>	<p>http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/ngos/CEDEHM-JPNH-MUKIRA_ForTheSession_E.pdf</p>

Shtojcë. 2

Pyetësi mbi masat legislative dhe masa të tjera sipas dispozitave të Konventës së Këshillit të Europës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje

(Konventa e Stambollit)



POLITIKAT E PËRFSHIRA DHE TË DHËNAT E MBLEDHURA (KREU II I KONVENTËS, NENET 7 -11)

Ju lutemi të jepni informacion mbi miratimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe koordinuara mbi dhunën kundër grave, burimet financiare të dedikuara për zbatimin e këtyre politikave, dhe mbështetja e punës së OJQ-ve dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, në veçanti organizatat e grave, krijimi i efektiv bashkëpunimi me këto organizata, si dhe mbledhjen e të dhënave.

A. Ju lutemi jepni detajet e planit / strategjive të veprimit (a) dhe çdo politikave të tjera përkatëse të miratuara nga autoritetet tuaja për të adresuar dhunën ndaj grave, siç përmendet në nenin 7. Ju lutem, përshkruani në mënyrë të veçantë:

1. cilat forma të dhunës janë të mbuluara;
2. afati (s);
3. cilat të drejta njerëzore të viktimave janë vendosur në qendër të këtyre politikave;
4. se si politikat janë të bashkërenduara për të ofruar një përgjigje efektive holistike dhe gjithëpërfshirëse;
5. masat e marra për zbatimin e tyre në nivel rajonal / vendor;
6. Progresi i bërë në zbatimin e tyre.

A. Ju lutemi të siguronit një përshkrim të burimeve financiare të alokuara për zbatimin e politikave të lartpërmendura, siç kërkohet nga neni 8, me një tregues të burimeve të financimit (shuma e financimit të ndarë dhe përqindjen e saj të buxhetit total vjetor të shtetit, shumën e financimit të ndarë dhe përqindja e tij e buxheteve rajonale, shumën nga burime të tjera).

1. Cila është puna e OJF-ve dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, në veçanti organizatat e grave, për të njohur, inkurajuar dhe mbështetur ato, siç kërkohet nga nenet 8 dhe 9?

2. Cilat masa janë marrë për të siguruar bashkëpunim efektiv me këto organizata në nivel kombëtar dhe rajonal / vendor?
3. Ju lutemi jepni detaje mbi autoritetin (et) e krijuara ose të caktuara për zbatimin e nenit 10.

Autoritetet e themeluara ose të caktuara a kanë një ose më shumë organe zyrtare për koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa?

Nëse është kështu, për secilin organ, ju lutem tregojnë

- a. Emri;
 - b. Statusi administrativ;
 - c. fuqitë dhe kompetencat;
 - d. Përbërja (në mënyrë të veçantë, ju lutem specifikoni nëse OJF-të aktive në luftën kundër dhunës ndaj grave janë anëtarë);
 - e. Buxheti vjetor;
 - f. burimet njerëzore (dmth numri i stafit, prejardhje e tyre të përgjithshme profesionale dhe çdo trajnimi për Konventën e pranuar); dhe
 - g. Rezultatet kryesore të marra nga themelimi i saj.
1. Autoritetet tuaja të krijuara ose të emëruara kanë një ose më shumë të organe të veçanta për monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa?

Nëse është kështu, për secilin organ, ju lutem tregoni

- a. Emrin;
 - b. Statusin administrativ;
 - c. kompetencat;
 - d. Përbërja (në mënyrë të veçantë, ju lutem specifikoni nëse OJF-të aktive në luftën kundër dhunës ndaj grave janë anëtarë);
 - e. Buxheti vjetor;
 - f. burimet njerëzore (dmth numri i stafit, prejardhje e tyre të përgjithshme profesionale dhe çdo trajnimi për Konventën e pranuar); dhe
 - g. Rezultatet kryesore të marra nga themelimi i saj.
1. Ju lutem specifikoni subjektet e mbledhjes së të dhënave të rëndësishme dhe llojin e të dhënave të mbledhura nga secili prej tyre.

Si është mbledhur dhe janë bërë publike të dhënat në nivel kombëtar?

Ju lutemi jepni informacion mbi ndonjë hulumtim të mbështetur nga qeveria juaj në lidhje me nenin 11 paragrafi 1b në vitet 2011-2015.

Ju lutemi jepni informacion mbi ndonjë sondazh të popullsisë për dhunën ndaj grave, siç kërkohet me nenin 11, paragrafi 2.

Për çdo anketë, ju lutem tregoni

1. Format e dhunës së mbuluar;
2. arritjen e saj gjeografike (shtet, rajonal, lokal);

3. Rezultatet e saj kryesore; dhe
4. nëse rezultatet janë bërë publike (me një tregues të burimeve).

PARANDALIMI

(KREU III I KONVENTËS, NENI 12 -17)

